



Ministri i Mbrojtjes Vengu: Strategji e qartë në përballje me kërcënimin e fenomenit të dezinformimit



Përfundoi detyrën si Komandant i KFOR-it, ministri Vengu pret gjeneralmajorin Özkan Ulutaş

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu priti në një takim të veçantë gjeneralmajorin Özkan Ulutaş, në përfundim të detyrës si Komandant i KFOR-it.

Ministri Vengu e falënderoi gjeneralmajor Ulutaş për punën e mirë që ka bërë si komandant i KFOR-it, duke i uruar njëherësh edhe suksese në detyrën e re, që pritet të marrë në Turqi.

Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i KFOR-it diskutuan rreth situatës së krijuar në veri të Kosovës. Ministri Vengu e informoi komandantin e KFOR-it se në takimet që pati me drejtues të institucioneve të Kosovës, theksoi se, duhen bashkërenduar veprimet me aleatët dhe me KFOR-in.

Komandanti i KFOR-it u shpreh se situata në terren nuk është edhe aq e qetë. Ndaj të dy bashkëbiseduesit ranë dakord që përmirësimi i raporteve mes palëve do të sillte edhe një përmirësim të situatës në terren. Megjithatë, ministri i Mbrojtjes theksoi se është e rëndësishme që Policia e Kosovës të vazhdojë të konsiderohet si forca e parë reaguese dhe të qëndrojë si e tillë.

Gjatë bisedës, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu dhe komandanti i KFOR-it biseduan edhe për përpjekjet e Shqipërisë për rigjallërimin e Industrisë Ushtarake.



Zjarret në Greqi, Shqipëria solidarë në ndihmë me mjete dhe efektivë zjarrfikës

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë i është përgjigjur menjëherë kërkesës së autoriteteve greke për ndihmë në shuarjen e zjarreve, që vijnë prej tre ditësh në Xilocastro, Peloponez.

Nën koordinimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile dhe Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile, në operacionet për shuarjen e zjarreve në Greqi do të angazhohen 30 zjarrfikës dhe 5 automjete zjarrfikëse nga Shqipëria.

Efektivët zjarrfikës nga Shqipëria do të angazhohen në bazë të nevojave të paraqitura nga vendi fqinj dhe do të qëndrojnë aty deri në stabilizimin e situatës. Shqipëria, si anëtare e Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile është përherë e gatshme të ndihmojë aleatët dhe partnerët e saj në raste e fatkeqësive natyrore.



Komandanti i Forcës Tokësore priti në takim nënkolonelin Nicholas Peter Colquhoun

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në një takim kortezie komandantin e Njësisë I Ranger, nënkolonel Nicholas Peter Colquhoun.

Gjeneral Xhebexhia, pasi iu uroi mirëseardhjen nënkolonel Nich Colquhoun dhe i falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm u fokusua te stërvitja “Strong Eagle-4”, e cila u zhvillua në Pashaliman, Zall-Herr dhe në rajonin stërvitor të Bizës, në të cilën morën pjesë 15 efektivë të Regjimentit të Operacioneve Speciale dhe 22 ushtarakë të Regjimentit të 3-të Ranger.

Kjo stërvitje u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet ROS dhe palës britanike me qëllim rritjen e aftësive operationale dhe ndërvepruese midis ROS dhe forcave aleate në përbushjen e detyrimeve të FARSH në NATO.

Në këtë takim, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Xhebexhia theksoi nevojën e rritjes së bashkëpunimit me palën britanike në të ardhmen.

Takimi vijoi me nënkolonel Ajet Jatën, komandant i Regjimentit të Operacioneve Speciale, ku u diskutuan arritjet e deritanishme të bashkëpunimit midis ROS dhe Regjimentin III Rangers.

Në këtë takim u diskutuan dhe projektet e bashkëpunimit midis ROS dhe Regjimentin I Ranger, me fokus kryesor mundësimin e kurseve në Britaninë e Madhe, si dhe vijimi i trajnimit të stërvitjeve “Strong Eagle”.



Ministri i Mbrojtjes Vengu: Nevojitet strategji e qartë për përballjen me kërcënimin e fenomenit të dezinformimit

Gjatë seancës dëgjimore të Komisionit të Posaçëm për luftën kundër dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja në proceset demokratike, drejtuar nga kryetari Erion Braçe, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vuri në dukje nevojën për një strategji të mirë organizuar për t'u përballur me këtë fenomen në rritje.

Ministri Vengu theksoi se Shqipëria nuk është e përjashtuar nga kërcënimet e dezinformimit, i cili, ndër të tjera, vjen në formën e dezinformimit operacional dhe propagandës së financuar nga vende me influencë malinje jashtë NATO-s dhe BE-së.

Në lidhje me identifikimin e burimeve të dezinformimit dhe koordinimin me partnerët ndërkombëtarë, Vengu u shpreh se vendi ka mundësitë e nevojshme për të përmbushur këto detyra. Ai nënvizoi nevojën për bashkëpunim mes institucioneve shtetërore dhe sektorit privat, përfshirë kompanitë e telekomunikacionit dhe platformat e mediave sociale, si dhe hapat ligjorë dhe teknikë për të cilët Komisioni mund të kontribuojë.



Ministri Vengu inspekton punimet për ndërtimin e godinës multifunktionale në Repartin e Operacioneve Speciale në Zall-Herr

Forcat e Repartit të Operacioneve Speciale në Zall-Herr do të kenë shumë shpejt qendrën multifunktionale, punimet për të cilën janë realizuar aktualisht në masën 80%.

Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu së bashku me atasheun ushtarak amerikan në Shqipëri, kapiten i rangut II Eric Cote, inspektuan punimet që po kryhen në këtë godinë, ndërtimi i të cilës ka nisur në prill të vitit 2023 dhe pritet të përfundojë sipas planit në qershor të vitit të ardhshëm.

Komandanti i ROS, nënkolonel Ajet Jata tregoi për detajet e këtij projekti. Ata vizituan edhe mjediset e palestrës dhe hambarit të skafeve, të cilat tashmë janë funksionale. Gjatë inspektimit, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu u shpreh se: "Forcat Speciale janë kapacitet kombëtar dhe, pesha e përgjegjësisë është më e madhe për t'u përballur me operacione mjaft specifike. Ju keni patur një historik shumë të mirë nga pikëpamja e certifikimit të personelit sipas standardeve të NATO-s, madje edhe përtej pritshmërive kalendarike. Ne duhet që, këtë përkushtim të personelit tuaj, ta mbështesim jo vetëm nga pikëpamja e trajtimit në pagë dhe në vështirësi pune, jo vetëm në infrastrukturë, pasi investimet do të vazhdojnë këtu, por edhe sa i përket mjeteve të logjistikës që përdorin".

Reparti i Operacioneve Speciale në Zall-Herr, prej disa vitesh i është nënshtruar rikonstruksionit me faza. Godina shumëfunktionale do të ketë një kapacitet për rreth 400 forca speciale. Po ashtu ajo do të ketë edhe një poligon modern për kryerjen e qitjeve



me armët e lehta. Në këtë objekt janë parashikuar edhe ambiente, ku efektivet mund të kalojnë kohën e lirë. Kjo godinë do të ketë gjithashtu edhe një sallë të veçantë për komunikimin me NATO-n.

Reparti i Operacioneve Speciale vazhdon stërvitjet intensive në kuadër të Stërvitjes për vlerësimin kombëtar të "SOLTG", që do të zhvillohet në fillim të muajit tetor 2024.



Gjeneralmajor Arben Kingji përshëndet stërvitjen “Dimali - 24”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Kingji mori pjesë në ceremoninë e DVD të stërvitjes “Dimali-24”.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Xhebexhia, komandanti i Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut kolonel Marku, atasheu ushtarak i Kosovës kolonel Hoti, shefi i Shtabit të Forcës Tokësore të FSK-së, kolonel Berisha, etj.

Gjeneralmajor Kingji, pasi falënderoi të pranishmit, u shpreh gjatë fjalës së tij se: “Zhvillimi dhe testimi i kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura është një ndër detyrat tona kryesore, pavarësisht nivelit të strukturës apo specialitetit të personelit. Stërvitja “Dimali - 24”, ka rolin e saj në drejtim të aftësimit për planëzimin dhe zhvillimin si të stërvitjeve dhe operacioneve të mundshme”.

Më tej gjatë fjalës së tij SHSHPFA vuri theksin në rëndësinë e veçantë që i jep kësaj stërvitje kompozimi i forcave pjesëmarrëse, me personel nga të tre batalionet e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut, si produkt i implementimit të strukturës së re si dhe pjesëmarrja e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës.

Duke vlerësuar përmbushjen me sukses të objektivave stërvitorë sipas skenarit të procedurave standarde, gjë e cila zhvillon më tej kompaktësimin dhe zhdërvjelltësinë e veprimeve dhe komandim-kontrollin, si element kyç në suksesin e operacioneve ushtarake, gjeneralmajor Kingji vuri theksin se kjo do të kontribuojë në arritjen e synimit tonë të zhvillimit të kapaciteteve opera-



cionale ushtarake të nevojshme për t’iu përgjigjur në kohë nevojave të brendshme, duke siguruar kontribute ushtarake modeste, por dinjitoze për misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, Bashkimi Evropian, apo OKB:

“Unë shpresoj se ju e keni shfrytëzuar këtë mundësi për të përmirësuar mangësitë dhe jetësuar mësimet e nxjerra gjatë stërvitjes 3-shkallëshe, që mbyllëm në muajin qershor, gjatë së cilës, ndër të tjera, u testuan edhe elementë të Planit Kombëtar

të Mbrojtjes, në mbështetje të Planit Rajonal Juglindor të NATO-s”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, solli në vëmendje periudhën intensive me aktivitete dhe stërvitje që FARSH janë aktualisht, qofshin këto kombëtare, apo shumëpalëshe, (“Strong Eagle 8”, trajnimin mbi Kërkim - Shpëtimin malor të efektivave të Batalionit të Emergjencave Civile në Pozmatinë, Kosovë, si dhe pjesëmarrja në

stërvitjen paradislokuese KFOR në Hohenfels Gjermani). Në përmbyllje të fjalës së tij, pasi falënderoi dhe përgëzoi gjithë pjesëmarrësit në këtë stërvitje, gjeneralmajor Kingji adresoi një falënderim të veçantë për personelin nga Forca e Sigurisë së Kosovës, të cilët morën pjesë në stërvitje dhe përfaqësuesit e tyre që nderuan me pjesëmarrjen në këtë ceremoni, duke i siguruar për mbështetjen e pakursyer të vendit tonë në drejtim të transformimit dhe zhvillimit profesional të FSK-së.



Gjeneralmajor Arben Kingji pret Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, priti në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

Kjo vizitë vjen teksa gjeneralmajor Ulutaş i afrohet përfundimit të mandatit të tij si komandant i KFOR-it, dhe kishte si fokus rritjen e bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të RSH dhe misionit të NATO-s, si dhe arritjet dhe problematikat e evidentuara prej tij.

Shefi i SHPFA, gjeneralmajor Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen, e falënderoi gjeneralmajor Ulutaş për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar gjatë periudhës që ai ka mbajtur detyrën e rëndësishme të komandantit të KFOR-it, për bashkëpunimin e frytshëm institucional; rolin që KFOR ka luajtur për sigurinë në Kosovë dhe në rajon; mbështetjen e personelit të FA-së që shërbejnë në këtë operacion, si dhe ndihmën e dhënë në përbalimin e emergjencave të zjarreve gjatë stinës së verës në zonën veriore të Shqipërisë.

Më pas, diskutimet u fokusuan në situatën e sigurisë në Kosovë dhe rajon, duke shprehur shqetësimet të përbashkëta në lidhje me rreziqet dhe kërcënimet që i kanosen mjedisit të sigurisë, duke theksuar nevojën për t’u angazhuar në dialog konstruktiv në interes të një mjedisi të sigurt dhe të qetë në Kosovë dhe rajon.

Nga ana e tij, komandanti i KFOR-it, gjener-



almajor Ulutaş, pasi falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji për mikpritjen, vlerësoi rolin e vendit tonë për stabilitetin e rajonit dhe kontributin domethënës të Shqipërisë në misionin KFOR, ku ushtarakët shqiptarë kanë treguar dhe tregojnë një performancë të lartë.



Major Bledar Mesi, kampioni i FARSH-së, rrëmben 6 medalje në Kampionatin Ballkanik të Atletëve Master, në Mal të Zi

Përfundon Kampionati i 33-të Ballkanik i Atletëve Master në Tivar, Mali i Zi. Major Bledar Mesi, përfaqësues i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, shpallet atleti më i mirë, duke fituar gjithsej 6 medalje. Me një performancë të jashtëzakonshme, ai siguroi:

- Vendin e parë dhe medaljen e artë në garën e 5000 metrave
- Vendin e parë dhe medaljen e artë në garën e 3000 metrave
- Vendin e parë dhe medaljen e artë në garën e 3000 metrave me pengesa
- Vendin e parë dhe medaljen e artë në garën e 800 metrave
- Vendin e dytë dhe medaljen e argjendtë në stafetën 4x100 metra
- Vendin e dytë dhe medaljen e argjendtë në Stafetën Ballkanike

Një sukses i jashtëzakonshëm për major Mesin dhe një krenari për Forcat e Armatosura.



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizoi në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes ceremoninë e fillimit të kurseve institucionale për oficerët e karrierës nga Forcat e Armatosura Shqiptare, FARSH dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, FSK. Në aktivitet morën pjesë: zëvendësministri i Mbrojtjes z. Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, ambasadori i Republikës së Kosovës i akredituar në Tiranë, z. Skënder Durmishi, komandantë të forcave kryesore dhe autonome të FA-së, drejtorë të SHPPFA-së si dhe staf mbështetës/pedagogjik etj. Komandanti i Kolegjit, gjeneral brigade Ylli Pulaj në fjalën e tij të rastit ndër të tjera u shpreh: “Më lejoni që në emër të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë t’ju uroj mirëseardhjen kursantëve nga Forcat e Armatosura të RSH dhe në veçanti nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Bazuar në Direktivën e Ministrit të Mbrojtjes 2024, vizionin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, misionin e Kolegjit, planet e arsimit/kualifikimit si dhe nevojat e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë ofron çdo vit katër Programe Studimi për katër kurset institucionale (KTHOSH, KKSH, KLO dhe KLSM) me pjesëmarrës nga Forcat e Armatosura Shqiptare, FSK, Institucionet e Sigurisë Kombëtare si dhe vendet partnere dhe ato aleate. Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë vitin e kaluar akademik 2023-2024, startoi për herë të parë, me realizimin e mësimdhënies në gjuhën angleze për Kursin e Lartë të Oficerit me 2 Module, duke sjellë një risi në historikun e arsimit tonë ushtarak, ndaj këtë vit të ri do të vijohet drejt rrugëtimit që në një të ardhme të afërt ky kurs të jetë rajonal dhe e gjithë infrastruktura mësimore të ofrohet në gjuhën Angleze”. Staf drejtues dhe akademik i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë punon vazhdimisht për të sjellë dhe reflektuar ide të reja inovative, për të qenë në kohezion me Kolegjet e Mbrojtjes së vendeve të NATO-s: me përgatitje të kurrikulave, programeve, cilësi në mësimdhënie, leksione të përditësuara me të reja më të fundit nga zhvillimet e institu-



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë starton vitin akademik 2024-2025



cioneve me rëndësi të sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Më tej gjeneral brigade Pulaj falënderoi Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes, për mbështetjen mbi kompletimin me pajisje të reja të ambienteve dhe klasave, duke përmirësuar dukshëm kushtet e punës dhe të mësimdhënies

dhe shprehu angazhimin e personelit mësimdhënës dhe mbështetës të KMS-së, për përbushjen më sukses të detyrave dhe objektivave për vitin e ri akademik 2024-2025.

Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes përsëriti zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Enkelejd Joti, i cili solli në vëmendje rëndësinë e këtyre kurseve për

rritjen profesionale dhe akademike të Forcave të Armatosura.

Gjithashtu zëvendësministri Joti u shpreh në fjalën e tij të rastit se: “Ministria e Mbrojtjes do të jetë mbështetëse e iniciativave të gjitha strukturave të Forcave të Armatosura drejt standardizimit të simotrave tona në aleancën e madhe Euroatlantike”.



Prof. Dr. h.c Ulrich Blum zhvilloi leksion për stafin akademik të KMS-së dhe AFA-së

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, Prof. Dr. h.c Ulrich Blum nga Instituti për Teknologji dhe Ekonomi, Gjermani.

Gjeneral Pulaj fillimisht i uroi mirëseardhjen dhe e falënderoi për pjesëmarrjen e tij në leksionin referuar stafit akademik, kursantët e kursit të Lartë të Oficerit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe stafin pedagogjik të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Më pas, të pranishmit patën mundësinë të ndjekin temën: “World Power Assessment, Strategic Drift, and the Role of Small Nation”, prezantuar nga Prof. Dr. h.c Ulrich Blum, i cili u ndal në vlerësimin e fuqisë botërore, vendosja



gjeostrategjike dhe rolin e shteteve të vogla.

Nisur nga niveli akademik dhe shkencor që Profesor Blum përfaqëson, interesi për ta dëgjuar atë ishte i lartë si një mundësi shumë e mirë për të marrë njohuri dhe diskutuar mbi temën.

Komandanti i Forcës Detare bullgare, vizitë zyrtare në Shqipëri

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Bullgarinë, komandanti i Forcës Detare të Bullgarisë, nënadmiralin Kiril Mihaylov zhvilloi një vizitë zyrtare në Shqipëri, ku u prit nga kundëradmiral Adnand Agastra. Gjatë takimit u diskutua mbi rritjen e mëtejshme të fushave të bashkëpunimit midis të dy vendeve.



Operacion SAR nga anija “Oriku” me mision në detin Egje

Anija e Forcës Detare “Oriku”, pjesë e misionit të NATO-s në detin Egje, në bashkëpunim me Rojën Bregdetare turke dhe Rojën Bregdetare greke, i kanë ardhur në ndihmë një gomoneje me 53 emigrantë, mes tyre 10 gra dhe 33 fëmijë.

Mjeti lundruar pësoi një defekt gjatë lundrimit në ujërat e detit Egje dhe falë ndërhyrjes së shpejtë të Rojës Bregdetare, të gjithë emigrantët u shpëtuan.

Forca Detare/Roja Bregdetare vazhdon misionin e saj fisnik në kuadër të Aleancës.



U zhvillua konferenca kryesore planëzuese e stërvitjes “Rrjedhja e Vjosës - a24”

Në mjediset e Forcës Ajrore u zhvillua Konferenca kryesore planëzuese e stërvitjes “Rrjedhja e Vjosës - 24”. Realizimi i kësaj stërvitje, e cila do të zhvillohet në nëntor 2024, do të synojë aftësimin dhe testimin e kapaciteteve operationale të shtabit të FAj, QKR dhe Bazës Ajrore Farkë, në zbatimin e etapave të planifikimit dhe ekzekutimit të saj.

Kjo stërvitje do të jetë stërvitje komando - shtabi e koordinuar me dislokim të mjeteve ajrore.

Gjatë kësaj konference u diskutuan objektivat e stërvitjes, si dhe ato të trajnimit, bazuar në direktivën e stërvitjes së FARSH, si dhe në direktivën e NATO-s për arsimimin dhe trajnimin kolektiv.



U zhvillua Konferenca Fillestare Planëzuese e stërvitjes “Ambicia e Shqiponjës - 24”

Qendra e Kontroll-Raportimit në Forcën Ajrore, zhvilloi procesin e planëzimit të stërvitjes “Ambicia e Shqiponjës - 24”.

Në Konferencën Fillestare të Planëzimit të zhvilluar në mjediset e FAj, u diskutua mbi ngritjen e skenarëve, konceptin, strukturat pjesëmarrëse, audiencën trajnuese, objektivat e stërvitjes dhe të trajnimit, si dhe nivelin e stërvitjes.

Stërvitja “Ambicia e Shqiponjës - 24”, e planifikuar të zhvillohet në fund të tetorit, do të jetë një stërvitje ajrore, e nivelit taktik, stërvitje reale me trupa LIVEX.

Qëllimi i kësaj stërvitje është shfrytëzimi dhe testimi i kapaciteteve të QKR në vend-instalimin e radarit në Midë, për ngritjen dhe funksionimin e sallës operationale dhe realizimin e pjesshëm të misionit dhe detyrave të kësaj sale, si dhe për vëzhgimin e hapësirës ajrore të Shqipërisë nëpërmjet radarit TPS-77.

Kontingjenti XV EOD përfundoi stërvitjen certifikuese “Silver Arrow-24”, në Camp Adazi, Letoni

Toga EOD, pjesë e Kontingjentit XV, i cili i është atashuar Grup-Batalionit shumëkombësh të Prezencës së Përparuar të Përforcuar, në Letoni, ka realizuar me efektivitet të lartë angazhimet në kuadër të stërvitjes certifikuese “Silver Arrow-24”.

Toga EOD e dislokuar në rajonin e stërvitjes në Camp Adazi, performoi shtatë skenarë të ndryshëm, duke treguar aftësi në lidhje me teknikat, taktikat dhe procedurat e ndjekura për neutralizimin e rrezeve që vijnë si rezultat i municioneve të paplasura dhe pajisjeve shpërthyes të improvizuara.

Efektivët e togës EOD, ndër të tjera, në kuadër të skenarit të një sulmi të mundshëm ndaj Camp Adazit, kryen detyrën për ngritjen e kurtheve sinjalizuese, të cilat rezultuan shumë efikase.

Kontingjenti XV EOD, demonstroi një nivel të lartë përgatitje profesionale, në bashkëveprim të ngushtë dhe me forca të tjera pjesëmarrëse të vendeve aleate të NATO-s.



Efektivët e kompanisë së kërkim-shpëtimit të Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile përfunduan trajnimin e kërkim-shpëtimit malor në Kosovë

Përfundoi “Kursi bazë dhe i avancuar i kërkim-shpëtimit malor”, i cili u zhvillua në Qendrën Ndërkombëtare të Kërkim-Shpëtimit, në Pomoztin, Kosovë. Në këtë kurs morën pjesë 12 efektivë të kompanisë së kërkim-shpëtimit të Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile.

Për më shumë se tre javë efektivët e kompanisë së parë operationale, morën njohuri teorike dhe praktike për kryerjen e operationeve të kërkim-shpëtimit malor, ngjitjen dhe zbritjen nga kulla, ngjitje dhe zbritje nga shkëmbi, ngjitja e vija ferrates, për tejkalimin e pengesave ujore, instalimin e urave me litar, jetesën në kushte fushore, dhënia e ndihmës së parë dhe evakuimin e të plagosurve, duke i shërbyer kështu rritjes së mëtejshme profesionale, në interes të përmbushjes së misionit të tyre.

Komanda Mbështetëse do të mbështesë në çdo kohë iniciativat e bashkëpunimit në fushën e arsimimit dhe kualifikimit, brenda dhe jashtë vendit, duke e vënë theksin në struktura me rol të rëndësishëm në përballimin e emergjencave civile.





KOLONEL HYSNI GJERGJI

Në Samitin e NATO-s në Vilnius, në vitin 2023, liderët e Aleancës vendosën të krijojnë një Qendër të Sigurisë Detare Kritike të Infrastrukturës Nënujore, në kuadër të Komandës Detare të Aleancës (Komanda Detare MARCOM), ndërsa në fillim të vitit 2023 Bërthama e Koordinimit të Infrastrukturës Nëndetare u krijua në selinë e NATO-s në Bruksel. Një kërcënim i padukshëm fshihet nën sipërfaqen e detit, madje në shtratin e detit. Këto kërcënime të reja nuk janë kuptuar akoma mirë, pasi nuk kanë ndodhur më parë. Pas sulmeve në linjën nënujore të gazsjellësit “Nord Stream”, qeveritë në mbarë botën janë “zgjuar” që të mbrojnë më mirë nënujin dhe kabllo të nënujore. Të përballur me faktet e reja, Britania dhe Franca e kanë përfshirë sigurinë e infrastrukturës nënujore të kabllove dhe tubacioneve në Doktrinën e tyre Detare të 2024, për të siguruar aftësitë e nevojshme për këtë “luftë” të re të madhe të shtratin të detit. Sulmet e dyshuara Houthi mbi kabllo të nënujore në Detin e Kuq janë një kujtesë në kohë, e një realiteti të ri që po ven. Epoka e luftës në shtratin e detit, ku infrastruktura nënujore do të jetë gjithnjë e më e shënjestruar, ka ardhur.

Parashikimi i së ardhmes së këtij kërcënimi është i ndërlikuar, megjithatë trendi këtu është i qartë. Mënyra se si dronët detarë po riformësojnë luftën detare po bëhet më e qartë në Detin e Zi. Por shkalla në të cilën armët autonome nënujore (AUV), do të ndikojnë në luftërat e ardhshme është një arenë, ku ka të ngjarë të jetë lufta në shtratin e detit, deri tani misterioze dhe pak e elaboruar. Situatat e fundit në Baltik, Detin e Veriut, Detin e Zi dhe tani Detin e Kuq tregojnë për një ndryshim në mënyrën se si do të zhvillohen luftërat dhe luftërat hibride detare në veçanti. Sulmet në infrastrukturën nënujore ka të ngjarë të bëhen më të zakonshme, madje edhe të pritshme, si pjesë e betejave të sotme në zhvillim.


Një viktimitë e luftërave të ardhshme mund të jetë lidhja jonë me internetin kur një kablo ndërpritet dhe fatura e ngrohjes pasi gazsjellësi apo kabloja elektrike është hedhur në erë. Këto ngjarje mund të ndodhin mijëra milje larg, dhe qindra metra nën nivelin e detit. Është kurioziteti të tregosh incidente historike të luftës në shtratin e detit. Kur Britania preu kabllo gjermane telegrafike nënujore në Luftën e Dytë Botërore, ose operacioni i famshëm “Ivy Bells” i marinës amerikane për të kapur kabllo të nënujore sovjetike në Luftën e Ftohtë. Por shumë gjëra kanë ndryshuar që atëherë, gjë që e ka transformuar këtë fakt historik në kërcënim që ka mbërritur në epokën tonë.

Bota është gjithnjë e më e ndërlidhur, ku energjia, gazi natyror, nafta dhe sigurisht interneti, të gjitha mbështeten në infrastrukturën nënujore. Falë kësaj lidhjeje, është e imagjinueshme që një sulm në kabllo të energjisë në det të hapur në një vend mund të ndihet në faturat e energjisë elektrike në një vend tjetër. Natyra indirekte e ndikimit e bën infrastrukturën nënujore objektiva joshëse për luftën hibride dhe planifikuesit e saj. Në vështirësi të gjetjes së një fajtori dhe të një procesi të ngadaltë të atribuimit, politikanët cinikë dhe udhëheqësit autoritarë, kanë kohë ta mbushin boshllëkun me dezinformata. Shumë prej tyre janë të gatshëm të përhapin teoritë e konspiracionit dhe spekulimet e papërgjegjshme. Sulmet mund të jenë gjithashtu relativisht jo të sofistikuar por të thjeshta dhe pa shumë mjete speciale. Mund të kryhen nga zhytësit në ujë të cekët, ose nga një anije që tërheq një spirancë, madje edhe një rrjetë peshkimi. Edhe nëse fajtori dihet, mund të jetë e vështirë të vërtetohet se ka qenë sulm i qëllimshëm ose aksidental. Si flotat e sofistikuar, ashtu dhe anijet e vogla dhe aktorët jo shtetërorë mund ta shfrytëzojnë këtë. HAMAS ndërtoi (UUV) për të shkatërruar infrastrukturën izraelite të gazit natyror në det të hapur dhe kërcënimi është real aktualisht.

Tani është bërë e qartë që sulmet në infrastrukturën e shtratin të detit do të jenë të zakonshme në luftërat e ardhshme. Duket e paimagjinueshme që një sulm i mundshëm kinez në Tajvan të mos përfshijë të paktën kërcënimin e një lufte në shtratin e detit. Ishulli është i lidhur me Amerikën dhe botën me një numër kabllosh interneti nënujor. Shkëputja e tyre në fakt do të shkëputte ishullin, duke e bërë mbrojtjen dhe koordinimin shumë më të vështirë. Historikisht, Rusia është më e investuara në aftësitë luftarake sulmuese në shtratin e detit. Ajo ka një flotë nëndetëse bërthamore të projektuara për të transportuar nëndetëse të tjera bërthamore më të vogla të cilat mund të ndërhyjnë në infrastrukturën e shtratin të detit thellë. Kjo mbështetet nga anijet e specializuara, ku më e famshmja është “Yantar”, si dhe shumë asete të tjera.

Por ky lloj operacioni nëndetar, nuk kërkon domosdoshmërisht këto asete tradicionale të specializuara. Rritja e përdorimit të automjeteve autonome nënujore (AUV) mund t'i formësojë këto kërcënime në të ardhmen. Një AUV mund të lëshohet nga qindra apo edhe mijëra milje larg, t'i afrohet objektivit të tij pa u parë


KËRCËNIMI NËNUJOR, sfida më e re e sigurisë detare



dhe ta hedhë në erë. Mund të lokalizojë kabllo ose tubin, duke përdorur një mori metodash të aplikuara për inxhinierët dhe planifikuesit. Dhe mund të depozitojë një bombë, ose thjesht ta hedhë në erë. Por mjetet teknike për ta arritur atë janë të arritshme për shumicën e marinave. Dhe një numër në rritje i prodhuesve AUV kanë njohuritë e nevojshme për të ndërtuar armë të përshtatshme për luftën nëndetare. Kabllo të nënujore janë shumë më të rëndësishme se komunikimet me satelitë, pasi satelitët janë vetëm 3 për qind trafikut global. Satelitët kanë për të siguruar lidhjet në vende rurale apo si rezervë gjatë një emergjence, por mund të zëvendësojnë ato nuk kanë aktivitet fizik. “Ata nuk do të përballojnë transportin e qindra terabajt midis kontinenteve. Kjo gjë mund ta bëjnë vetëm kabllo. Elon Musk është i popullarizuar në internetin satelitor, ky lloj sistemi nuk ofron një zëvendësim për kabllo të nënujore.

Britania ka deklaruar se nëndetëset ruse i kanë monitoruar kabllo të nënujore janë të brishta dhe dëmtohen shumë lehtë. Çdo vit, nuk ka më shumë se 100 incidente, të qëllimshme ose jo, ku kabllo priten ose dëmtohen. Shumë prej tyre shkaktohen nga transporti me anije apo dëmtimi mjedisor. Megjithatë, në fund të fundit, ka pasur probleme në rritje për sabotimet. Kompanitë që dërgojnë të dhëna në rrjetin kabllo të internetit, nuk përdorin vetëm një kablo, kanë alternativa në kablo të ndryshme. Nëse një kablo pëson defekt, trafiku ridrejtohet përmes të tjerëve. Por në disa zona, si në ishullin Tonga, ku ka vetëm një kablo, një shkëputje mund të ketë shkatërruese.

Siguria e ujërave dhe nënujiti paraqitet të jetë një tjetër kërcënim potencial rus. Shefi i sapoemëruar i Shtabit të Përgjithshëm në Britaninë e Madhe, paralajmëron se ka pasur “një fenomen” në aktivitetet e nëndetëseve ruse gjatë 20 viteve të fundit, dhe Rusia ka rritur aftësitë për të vënë në rrezik në kablo të nënujore dhe për t'i shfrytëzuar potencialisht ato. Rusia ka një komandë nëndetëse, të drejtuar nga Drejtoria kryesore e Kërkimeve në det të njohura si “GUGI”, është e pavarur për



detajet e saj të FSB. Komanda GUGI është e vendosur në Gjirin Olenya në Arktik dhe është vendosur për silurin bërthamor balistik të Rusisë “Poseidon” që mbartet nga nëndetësja “Belogrod”. GUGI ka një anije të zbulimit “Yantar” si dhe përdor dy nëndetëse, të cilat lëshojnë mini-nëndetëse për operacione vëzhgimi dhe sabotimi në thellësi të detit. “Yantar” raportohet të ketë qenë aktive në Kanalin Anglez, në ujërat që kabllo të fibra optike dhe tubacione transatlantike të gazit dalin në breg.

Sabotazhi rus, gjatë tetorit 2022 deri në maj 2024, ka shqetësuar qeverinë norvegjeze për aktivitetet e tyre, duke përfshirë fluturimet me dronë zbulimi, rreth terminalëve norvegjeze të gazit, si dhe qendrave të komandimit operacional në Karste dhe Kolisnes. U raportua nga mediat gjithashtu për disa shtetas rusë të arrestuar nga autoritetet norvegjeze për spiunazh më 28 tetor 2022. Më 25 tetor 2022, ndodhi sabotimi në dy pjesë të kabllove të komunikimit me fibra optike “Shefa-2”, që bëjnë lidhjen midis Skocisë, Shetlandit, Danimarkës dhe Ishujve Faroe. Këto u konsideruan si aksidente “nga një anije peshkimi” nga propaganda ruse. Por sa mundet që një aksident të rezultojë në dy pika të tjera në ditë; dhe pse një anije “kërkimi” ruse ishte në të njëjtin territor detar atë ditë? Të gjitha argumentet, provat dhe analizat na bëjnë tek sabotimi rus. Disa ditë pas ndërprerjeve të “Shefa-2”, tre

kablo me fibra optike u prenë në Detin Mesdhe jashtë Marsejës, duke ndërprerë internetin në Evropë, SHBA dhe Azi.

Kablloja e linjës “the Asia-Africa-Europe-1 internet” shtrihet në një gjatësi prej 24.944 km, duke u lidhur me Hong Kongun Marsejën në Francë. Teksa gjarpëron nëpër Detin e Kinës Jugore dhe drejt Evropës, ajo ndihmon në sigurimin e lidhjeve të internetit në më shumë se 24 vende, nga India në Greqi. Kur kablloja u shkëput më 7 qershor, miliona njerëz mbetën jashtë linje dhe u përballën me ndërprerje të përkohshme të internetit. Kablloja, e njohur shkurt edhe si AAE-1, u këput në një zonë në Egjipt. Nga ajo ngjarje është edhe një kablo tjetër, ndërsa nuk dihet ende shkaku.

Më rëndë u godit Etiopia, që humbi 90 për qind të lidhjeve të saj me rrjetin, dhe më pas Somalia me 85 për qind. Po ashtu u ndërpreu edhe shërbimet i-cloud që i përkisnin Google, Amazon dhe Microsoft u ndërpreu gjithashtu. Edhe pse lidhja u rivendos brenda pak orësh, kjo ndërprerje nxjerr në pah brishtësinë e kabllove nënujore të internetit në botë, dhe rolin e madh që ka Egjipti dhe Deti i Kuq, aty pranë kanë në mjedisin e internetit. Kabllo të nënujore të cilat nuk janë të trasha janë të rrezikuara nga dëmtimet e ndryshme, ankorimet e anijeve dhe tërmete dhe përshkojnë 1931 km përmes Detit të Kuq, përpara se të kalojnë në Egjipt, në Detin Mesdhe, duke lidhur Evropën me Azinë. Në 2 dekadat e fundit kjo linjë është bërë linja globale, më e sigurt e internetit. Ky rajon që përfshin Kanalin e Suezit, është gjithashtu një pikë nevralgjike e transportit të mallrave. Kjo u vërtetua edhe nga kaosi që shkaktoi bllokimin e anijes së madhe të kontejnerëve “Ever Given” në mesin e kanalit në vitin 2021.

Kabllo të nënujore janë projektuar sipas standardit “pesë nënta” – që do të thotë se janë besueshëm në 99,999 për qind të rasteve, një nivel sigurie i rezervuar për armët bërthamore dhe anijet kozmike. Në të gjithë botën ka 436 kablo kryesore komunikimi, që të gjitha mes tyre më shumë se 800 000 milje fibër optike. Çdo ditë rrjeti kabllo bart transfera në vlerë prej 10 trilion dollarësh. “Babai” i gjithëve është “Asia American Gateway”, e cila është 12,430 milje e gjatë. Gjithçka transmeton nga katër deri në 20 fibra optike, ku një fibër mund të jetë deri në 400 GB, ose të tjera për rreth 375 telefona. Një shumë e vetme që përmban tetë fije fibra optike mund të transferojë përmbajtjen e Bibliotekës “Bodleian” të Oksfordit, e cila përmban më shumë se 12 milionë libra, revista dhe shkrime, përtej Atlantikut në 40 minuta.

Rusët provokojnë edhe në ngushticën e Otrantos, një vend ku janë përqendruar rrjetet që transportojnë gazin, energjinë dhe trafikun e internetit mes Italisë dhe Ballkanit. “Akademik Pashin”, një anije naftëmbajtëse e madhe ruse, qëndroi praktikisht e palëvizshme në 12 dhjetor 2022 në pikën më të ndjeshme: atë ku ndodhen tubat e Gazsjellësit Trans Adriatik, ‘çezma’ që përcjell furnizime alternative me gaz metan. Shqetësimet më të mëdha janë ngritur për të kontrolluar “Houthin” për sabotimin e trafikut ndërkombëtar të internetit dhe transmetimit të të dhënave, ku firmat e telekomit kanë dhënë alarmin për planet e grupit militant për të “prishur” kabllo të nëndetëseve në Detin e Kuq. Përafërsisht 17 për qind e trafikut të internetit në botë të gjithë përmes tubave me fibra optike kalon në Detin e Kuq. Më 24 dhjetor 2023, një kanal në Telegram me “Houthit” postoi një hartë që tregon konvergencën e kabllove të komunikimit në Detin e Kuq, Detin Mesdhe, Detin Arabik dhe Gjirin Persik. Do të ishte shumë e vështirë për të ndaluar “Houthit” nëse ata do të bënin një veprim të vendosur për të prishur këtë kablo. Një prerje e qëllimshme në një kablo pengon rrjedhën e të dhënave që janë të lidhura me internetin modern, ndërprerje e cila ka një kosto shumë të madhe ekonomiko-financiare dhe pasoja për sigurinë globale, rajonale dhe kombëtare.



**GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-N**

Kanë mbetur rreth 30 ditë, ndërsa establishmenti politik, mediatik dhe opinioni publik, në Uashington si dhe kryeqytetet e BE-së, NATO-s, etj., janë të fokusuar në zgjedhjen e Presidentit të 47-të SHBA-ve.

Në garë është rikthyer fuqishëm biznesmeni - Republikan Donald Trump, të cilin ndoshta “Zoti-vetë e shpëtoi nga 2 atentate”, ndërsa Demokratët me zëvendës presidenten Kamala Harris, e cila po përpiqet “dhëmb për dhëmb” të mbajë Shtëpinë e Bardhë, duke u përballur me (pa) mundësinë shëndetësore, arritjet dhe dështimet e Presidencës Biden.

Ndërsa kjo përballje ka sigurisht të përbashkët ardhmërinë e SHBA-ve, mbart gjithashtu edhe një kontrast të thellë mes dy rivaleve ndaj nevojës për reforma si dhe statukuosë së rolit të Shtëpisë së Bardhë dhe qeverisjes federale, ndaj krizës së besimit të demokracia, ekonominë, emigracionin, çështjet sociale, aborti, ambienti, politika e jashtme; marrëdhëniet me NATO-n, BE-në, Ukrainën, Lindjen e Mesme, Ballkanin, Rusinë, Kinën, etj.”.

Platforma Trump: dominohet nga një pakete politikash konservatore (të djathta) për të çliruar shtetin Amerikan nga “Deep State”, pra nga interesat e aktorëve të nëndheshëm (të pa votuar), burokracia me kollare demokratike, korrupsioni, filantropistët, orientimi majtist, etj.”. Me fjalë të tjera për ta ç’ burokratizuar, reformuar, modernizuar dhe forcuar pushtetin ekzekutiv të SHBA-ve, duke e ri-bërë Amerikën edhe më të madhe/fortë, ose një superfuqi të pakonkurueshme edhe për shekujt që vijnë!

Platforma Harris: një bashkim i projekteve Obama dhe Biden, pra një përpjekje për të ruajtur statukuonë si dhe modernizuar Shtëpinë e Bardhë; tejkaluar krizën ekonomike, krizën e besimit të demokracia funksionale si dhe forcuar rolin dhe imazhin e SHBA-së në botë.

Në këtë opinion, do të gjeni një përmbledhje krahasuese rreth 10 çështjeve thelbësore (ngjashmëritë & dallimet), në programet e Trump dhe Harris, duke u përpjekur po ashtu për të ofruar një panoramë me mesazhe euroatlantike për votuesit shqiptarë jo vetëm në SHBA.

Ekonomia

Shumica e amerikanëve e konsiderojnë ekonominë si një nga faktorët me peshe thelbësore në zgjedhje. Sipas Byrosë së Statistikave, inflacioni 8% në 2023, ka shkaktuar shqetësim për standardet e jetesës.

Trump-2: rikthimin te reformat radikale ekonomike (2017-21); kalimin nga taksat mbi të ardhurat në një taksë konsumi; thjeshtimin e taksave mbi të ardhurat individuale nga: 15% mbi të ardhurat në pagën bazë dhe 30% të ardhurat mbi të si dhe uljen e normë se taksës së korporatave nga 21% në 18, ndërsa me krenari kujton që Trump-1 (2017-2021), e uli nga 35% në 21%.

Harris: vijim i projektit Biden-2, pra një rritje të taksave për të pasurit dhe investime në programe sociale, pasi sipas Harris “qeveria duhet të luajë një rol aktiv në adresimin e pabarazive ekonomike”. Nga kjo qasje parashikon të mblidhen mbi 2 trilion \$ për t’i përdorur ato si investime në edukim dhe shëndetësi.

Emigracioni

Trump-2, bazohet në një politikë edhe më të rreptë (përveç murit-dixhital) të kontrollit të kufijve nga emigracioni paligjshëm në SHBA. Sipas një sondazhi të “Gallup”, 65% e amerikanëve mbështesin rreziqet e emigracionit të paligjshëm, ndërsa programi Trump-2, parashikon arrestimin dhe dëbimin e emigrantëve që jetojnë pa dokumente (ilegalë) në SHBA, duke përdorur edhe ushtrinë për zbatimin e ligjit.

Harris, zbaton një reformë të gjithanshme të emigracionit dhe thekson rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të emigrantëve. Ajo ka propozuar politika që lehtësojnë procesin e natyralizimit për ata që kanë kontribuar në shoqëri. Një raport nga “Pew Research Center” tregon se 78% e amerikanëve besojnë se emigrantët kontribuojnë pozitivisht në ekonominë amerikane.

Aborti

Trump-2, mbetet kritik ndaj politikave që mbështesin të drejtat e abortit. Edhe pse sipas një sondazhi të “Gallup”, 55% e amerikanëve mbështesin të drejtat e abortit, por Trump ka arritur të mobilizojë mbështetjen nga konservatorët që janë kundër tij. Ndërsa kujton se Gjykata e Lartë vendosi që Kushtetuta nuk i jep të drejtën abortit, duke jua lënë shteteve në kompetencë. Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore (HHS) do të shndërrohet në Departamentin e Jetës, si dhe do të miratojë mbrojtje ligjore më të fuqishme për lindjet e reja, veçanërisht për parandalimin e shtatzënisë në adoleshencë.

Harris: mbështetëse e të drejtave të abortit dhe për të garantuar aksesin në shërbimet shëndetësore për gratë. Ajo beson se çdo grua duhet të ketë të drejtë të vendosë për trupin e saj, duke iu referuar raportit të “Guttmacher Institute”, ku 69% e amerikanëve mbështesin këtë qasje.

Politika e jashtme

Trump-2, një politikë të fortë konservatore, që nga kundërshtarët interpretohet si “izolim”, ndërsa Trump insiston se SHBA duhet të fokusohet më shumë në çështjet e brendshme (Amerika e para). Ai mbetet kritik ndaj disa marrëveshjeve ndërkombëtare si ajo e

Trump - Harris, zgjedhje midis reformave ose statukuosë në SHBA



Parisit për Klimën, tregtare, etj. Një sondazh i “Gallup” tregon se 56% e amerikanëve e mbështesin këtë qasje në politikën e jashtme.

Harris: “SHBA duhet të luajë një rol edhe më aktiv në skenën ndërkombëtare”. Mbështet diplomacinë si mjet prevalues/bazë për të zgjidhur konfliktet dhe për të promovuar paqen. Një raport nga “Center for American Progress” tregon se 70% e amerikanëve besojnë se diplomacia është e nevojshme (por jo e vetme) për të zgjidhur problemet globale dhe mbrojtur interesat dhe imazhin e USA në botë.

Shëndetësia si dhe programet e mbrojtjes nga ndryshimet klimaterike

Trump-2: “Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore do të shndërrohet në Departamentin e Jetës”, duke promovuar opsione të tilla si “Medicare Advantage” që përfshin sigurimet private. Trump gjithashtu ka propozuar kuponë për të lejuar përfutjesit të zgjedhin plane private, një përpjekje për të rritur konkurrencën në tregun e kujdesit shëndetësor.

Trump-2 parashikon të anulojë urdhrat ekzekutivë të Presidentit Biden për projektet për mbrojtjen nga ndryshimet klimaterike. Ai premtion braktisjen e strategjive dhe programeve përfshirë ligjet e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) dhe Administratës Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike (NOAA), të cilat i konsideron: “nxitësit kryesorë të industrisë së alarmit të ndryshimeve klimatike”.

Harris, edhe pse ka pasur disa ndryshime në qëndrimet e saj, vazhdon të mbrojë një sistem më të zgjeruar dhe më gjithëpërfshirës për Medicare. Ajo premtion “Medicare për të gjithë”, që do të zëvendësonte sigurimin privat me një program të menaxhuar nga qeveria, që synon të ofrojë mbulim të plotë shëndetësor për të gjithë qytetarët amerikanë.

Sistemi arsimor

Trump-2, mbështet zgjerimin e përzgjedhjes dhe kuponëve shkollorë, të cilët do t’i lejonin prindërit të përdornin fondet publike për të dërguar fëmijët në shkolla private. Arsimit do t’u lihet kompetencë e 50 shteteve të SHBA-së për të përzgjedhur programet, duke argumentuar se kjo qasje decentralizuar e “tregut Arsimor”, rrit konkurrencën dhe përmirëson cilësinë e arsimit. Trump mbetet kritik ndaj sindikatave të mësuesve dhe një rol më të kufizuar të Uashingtonit në sistemin arsimor, duke shkruar Departamentin e Arsimit (DoE), programet e të cilat ose do transferohen në agjenci të tjera ose do ndërpriten.

Harris: fokusohet në investimin në shkollat publike dhe përmirësimin e infrastrukturës së tyre, pasi mendon se shteti e ka detyrim parësor arsimimin e amerikanëve. Ajo mbështet shtimin e pagave të mësuesve dhe programe për të zvogëluar pabarazitë arsimore. Harris mbështet qasje më gjithëpërfshirëse në edukimin parashkollor. Ndryshe nga Trump, ajo është kundër përdorimit të kuponëve për shkolla private, duke theksuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit publik.

Çështjet sociale

Trump-2, ka premtuar një axhendë konservatore për përmirësimin e sigurisë publike si dhe mbështetje për policinë. Ai angazhohet se do të ndihmojnë në uljen e kriminalitetit dhe do të krijojë një ambient më të sigurt për qytetarët. Një sondazh i “Pew Research Center” tregon se 62% e amerikanëve besojnë se duhet të ketë më shumë mbështetje për policinë. Pornografia të quhet krim si dhe premtion heqjen e mbrojtjeve ligjore kundër diskriminimit bazuar në orientimin seksual, ngjyrës, etj.

Harris: mbështet reformën në sistemin e drejtësisë penale, pasi beson se është e nevojshme të adresohen pabarazitë racore dhe programe që mbështesin komunitetet e marginalizuara. Një sondazh i “Gallup” tregon se 70% e amerikanëve mbështesin këtë reformë.

Lufta në Ukrainë

Trump-2: Mbeten ende keq-interpretime dhe dilema të forta rreth vendosmërisë së Trump për ta gjunjëzuar ekonomikisht dhe gjeopolitikisht Rusinë – Putiniste. Edhe nga takimi para pak ditësh me presidentin Zelensky në Uashington, Trump përsëriti se: “nëse do ishte President, Putini ma një mirë vendosmërinë, prandaj as nuk do kishte ndërmarrë këtë marrëzi në shkurt 2022”, ndërsa garanoi se: “Trump-2 do ta mbyllë luftën”, pa dhënë detaje?! Mbas takimit edhe Zelensky konfirmoi se: “Trump/SHBA do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën nëse ai zgjidhet në nëntor”, ndërsa mohoi raportet që Ai/Zelensky mbështet rivalen demokrate Harris. Gjithsesi një sondazh i “Pew Research Center” tregon se edhe 54% e amerikanëve besojnë se SHBA-ja duhet të jetë më e ashpër ndaj Rusisë për agresionin e saj ndaj Ukrainës.

Harris: Mbështetje e fortë dhe pa kompromis deri në fitoren e Ukrainës, duke ri-konfirmuar vijimin e paketës së ndihmës ushtarake dhe financiare (disa qindra miliardë \$) për të mposhtur agresorët rus. Një raport nga Këshilli Atlantik konfirmon se 78% e amerikanëve mbështesin ndihmën për Ukrainën.

Lindja e Mesme dhe Ballkani Perëndimor

Trump-2: ka promovuar një axhendë të fortë për mbrojtjen e interesave Amerikane në Lindjen e Mesme si dhe Ballkanin Perëndimor. Kështu “zgjidhje të forta” ka edhe për ndalimin e përshkallëzimit të konfliktit në lindjen e mesme, përballien e Izraelit me Shtetet dhe Organizatat Terroriste (Hamasin, Hezbollah). Ndërsa për paqen në Ballkan, do të “imponohet” zbatimi i marrëveshjes së nënshkruar në dhomën ovale, midis Serbisë dhe Kosovës në mandatin e Trump-1 (09/2020).

Harris: mbështet fort Izraelin. Ka përsëritur shqetësimin dhe thirrjet për vetëpërmbytje si dhe një qasje më të balancuar ndaj të drejtave të palestinezëve. Ajo premtion se gjatë mandatit të Saj (nëse fiton) do të arrihet një zgjidhje e drejtë/pranueshme për të dy palët. Një raport nga “Pew Research Center” tregon se 52% e amerikanëve mbështesin paqen, bazuar në një marrëveshje mirëbesimi dhe të bashkëjetesës paqësore mes shteteve dhe popujve në rajon.

NATO, BE dhe Kina

Trump-2: “një SHBA e pakonkurueshme, një NATO dhe BE më e fortë, pra për një botë edhe më e sigurt, mbeten qasja e fortë e projektit Trump-2”. Ndërkohë kujtojmë që falë edhe kërcënimit të Tij të shumëpërfolur: “vendet që nuk respektojnë këto kuota (2%) nuk do të mbrohen nga NATO”, nga më pak se 5 (2017) sot 25 vende anëtare kanë rritur shpenzimet ushtarake në 2% të GDP (2024), ndërsa BE arriti në 500 miliardë € shpenzimet për mbrojtjen.

Kinën e konsideron një kërcënim serioz për SHBA-të dhe ka premtuar një qasje edhe më agresive se në mandatin e tij të parë, duke përfshirë tarifa të larta ndaj importeve kineze dhe mundësinë e një marrëveshjeje të re me Xi Jinping, duke kritikuar ashpër Presidencën Biden - Kamala. Projekti shpreh gjithashtu shqetësim për vjedhjen kineze të pronësisë intelektuale dhe akuzon “Big-Tech” se veprojnë në emër të PKK, për të minuar SHBA-në. Prandaj inkurajon evidentimin e “rreptë” të kompanive të SHBA-së që kërkojnë të investojnë në Kinë, të cilat do të përballen me kufizime deri të revokimi lejës.

Harris: mbron vazhdimësinë e përkushtimit të SHBA-së ndaj NATO-s, si gur themeli për sigurinë globale. Sa i përket Kinës, ka një qëndrim të vendosur kundër abuzimeve të të drejtave të njeriut dhe angazhimeve të Kinës në Detin e Kinës Jugore, duke e parë këtë si sfidë për rendin ndërkombëtar. Politikat do të jenë më të balancuara, duke promovuar bashkëpunimin, ku është e mundur, por duke qëndruar të fortë kundër ndikimit ekonomik të Kinës edhe në Ballkan.

E jotja është të më shpallësh luftë, e imja të fitoj!

Tetori Rozë shënohet botërisht si muaji i sensibilizimit të Luftës Kundër Kancerit të Gjirit. Por, si zhvillohet kjo luftë? Duke luftuar pa u dorëzuar dhe duke parandaluar përmes kontrolleve të rregullta. Me këtë betejë përballet çdo ditë një ushtri e madhe grash në çdo cep të globit, por, a e dini se këto gra dinë diçka që ne nuk dimë?

Ditët e tyre janë plot jetë, ndërsa jetët tona përbëhen nga ditë bosh. Ditët e tyre duken të shkurta, pasi kanë kuptuar thelbin e jetës, ndërsa tonat të gjata pa fund dhe pa kuptim.

Spitali, ky vend kaq i vogël bëhet vend i shpresave të mëdha, i lutjeve dhe altruizmit, i të qenit me çdo kusht, veç mos vuajnë ata që duan ato më shumë. Kur dikush më pyet ç' është ajo që të ka mrekulluar në jetë, me plotë gojë them: "pikërisht, këto gra".

Përpjekja e tyre për ta fituar luftën, kur duket sikur 'djallit të zi' i thonë: "e jotja është të më shpallësh luftë, e imja të fitoj".

Rastësisht isha dëshmitare në një kurorëzim me një vajzë të re që prej vitesh kishte mundur s'di sa herë "djallin e zi", çuditërisht nuk ishim takuar më parë në udhët e gjata të jetës. Stili i saj i flokëve të shkurtër ishte gjëja më e veçantë që kisha parë, kombinuar me veshjen, vetëbesimin, bukurinë...

Unë: Më pëlqen kjo prerje flokësh.

Ajo: Po, edhe mua tani më pëlqejnë. Por, s'është se i kam prerë, efekt anësor i kimio-terapisë. (Sikur më vuri në një test, më të rëndin deri atë ditë).

Unë: Imagjino që ndonjëherë bien sëmundjet për të gjetur stilin e flokëve që na shkon më shumë. (Qeshëm të dyja).

Ajo: Është humori që na duhet më shumë se mëshira dhe keqardhja që na e japin njerëzit zakonisht.

Rrodhi një bisedë e gjatë mbi këtë temë, ku shihja një kënd të ri prej ku bota dukej më qartë, më me shumë ngjyra.



Prandaj gratë duhen të bëhen bashkë për t'ia zgjatur dorën njëra-tjetrës. Secilës për t'ia treguar rrugën, për ta drejtuar atje ku duhet, si duhet. Për të marrë ndonjë këshillë, për të ndarë përvoja. Ndhimë profesionale që askujt nuk i shkon ndërmend ta ofrojë. Shërimi i çdo sëmundjeje fillon nga gjendja mendore. Gratë që më frymëzojnë, inspirojnë janë këto që ballafaqohen me këtë luftë çdo ditë, ditën dhe natën kur gjejnë strehë për të qarë, kur nuk i sheh askush. Është luftë e përditshme e përbërë nga



pafundësisht beteja, pa u lodhur e pa pushuar, luftë me tumoret, metastazat, luftë për t'i zgjatur momentet me njerëzit që duan.

Jeta është e bukur dhe kush më së miri se këto gra e dinë këtë. Ato nuk shqetësohen më për veshjet firmato, për zgjatjen e thonjeve, perdet e palara, për rrëmujën në shtëpi për gjëra të imëta e probleme të kota. Nuk i nxjerr asgjë prej takti, nuk e humbasin lehtë toruan, asnjë problem nuk u duket i madh e i pazgjidhshëm, asnjë situatë pa rrugëdalje derisa nuk lidhet me shëndetin e tyre. Kur mjaft të tjera kanë fontanë dëshirash, ato kanë vetëm një, duan të jenë. Nuk u vënë veshin njerëzve të pacipë e të paedukuar, qeshin karshi tyre, sepse dinë diçka që të tjerët nuk e dinë dhe sado të tmerrshme qofshin sëmundjet kanë dhe anën e mirë të tyre, kupton se nuk duhet ta vrasim mendjen për gjërat e vogla dhe të gjitha gjërat në jetë përveç shëndetit, janë të vogla.

Te asnjë grua s'kam parë të qeshur më të bukur e më me zemër sesa te këto gra. Ditët e tyre janë plot jetë, ndërsa jetët tona me ditë boshe shumë. Ato janë dielli vet që rrezatojnë e ngrohin edhe në ditët me shi.

Një filozof fillon e banon brenda tyre. Kanë tjetër maturi e pjekuri. Shijojnë ndryshe jetën, çastin, nuk shpërdorojnë më asgjë si më parë.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Njësitet guerile, shkollat e para të luftës


Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si formë organizative të forcave luftarake, në dhjetor 1941, nisën të formoheshin njësitet e para guerile me udhëzimin e PKS-H-së. Njësitet guerile u krijuan dhe vepruan paralel me çetat partizane në zona dhe krahina të ndryshme të vendit. Me fillimin e vitit 1942 në mjaft qytete kryesore të Shqipërisë nisën veprimtarinë luftarake njësitet guerile, ku dhe përqendrimi i pushtuesit ishte më i madh. Njësitet guerile u bënë shkollat e para të luftës, ku u mësua dhe u perfeksionua arti i të luftuarit.

Njësitet guerile me veprimet e pandërprera luftarake, në qytete u bënë tmerri i pushtuesit si nga ana psikologjike, por dhe ushtarake. Njësitet ishin grupe të vogla të armatosura, që përbëheshin nga 3-5 veta, ishin shumë të lëvizshme dhe vepronin në ilegalitet dhe konspiracion. Anëtarët e njësitit ishin luftëtarë ilegalë, që punonin ilegalisht dhe ditën apo natën kryenin veprime të fshehta. Njësitet ishin formacione të vogla dhe përbëheshin nga njerëz të thjeshtë, punëtorë, atdhetarë, antifashistë, nxënës shkollash, komunistë dhe ishin të vendosur, besnikë, të përkushtuar ndaj kauzës për të cilin kryenin dhe aksionin që iu ngarkohej. Anëtarët e njësiteve guerile ishin të zgjuar, të disiplinuar e të urtë, u dëgjohej fjala dhe merrnin mbi vete rrezikun deri në dhënien e jetës për atdheun. Zakonisht në qytete punëtorët përbënin masën më të madhe të njësiteve guerile.

Në Tiranë me fillimin e vitit 1942, vepronin 10 njësite guerile, ndërsa në fund të vitit kishte mbi 30, në Vlorë 2 dhe më pas 8, në Korçë 6 dhe më pas 10, në Shkodër 4 dhe më pas 7, dhe në Durrës 1 për ta mbyllur vitin me 6. Muaj pas muaji shtimi i tyre erdhi duke u rritur dhe u zgjerua edhe në qytete si në Elbasan, Lumë-Kukës, Berat, Dibër, Gjirokastrë, etj. Në mesin e vitit 1942 njësitet morën përmasa dhe në fshatrat përreth qyteteve. Numri i tyre shkonte deri në 15 veta. Njësitet e fshatrave përbënin një masë të madhe se njësitet në qytete, siç ishin qarqet e Korçës dhe të Vlorës. Në qarkun e Korçës, deri në qershor të vitit 1942 ishin ngritur 20 njësite guerile në fshatra. Nga janari deri në dhjetor 1942, kemi rënien heroike të anëtarëve të njësiteve guerile, të të rinjve antifashistë të cilët ishin në ballë të lëvizjes. Në të gjithë Shqipërinë, nga statistikat që disponojmë, del se në vitin 1942 kanë rënë në aksione të njësiteve guerile 146 dëshmorë. Sipas qarqeve: Berat 4, Dibër 4, Durrës 8, Elbasan 4, Fier 4, Gjirokastrë 12, Korçë 15, Lumë, Kukës dhe Malësia e Gjakovës 10, Lezhë 2, Shkodër 10, Tiranë 48 dhe Vlorë 25.

Gjatë vitit 1942 në Tiranë njësitet guerile dhe çeta partizane e Pezës kanë kryer një sërë aksionesh si: asgjësim spiunësh, djegie depush, marrje materiale, rrëmbim të shtypshkronjës "Gutenberg", djegie të centralit elektrik, djegie të depove të xhenios, marrje materiale etj. Gjithsej mbi 33 aksione të kryera. Në Tiranë kishte një komision ushtarak për drejtimin e njësiteve guerile sipas zonave. Në këtë komision ishin në krye Gogo Nushi, Beqir balluku, në maj 1942 i kaloi drejtimi Vojo Kushi dhe në tetor pas rënies së tij, Beqir Balluku dhe Shahin Ruka. Këtë njësite drejtohej nga komandantë syptrembur të njësiteve guerile të Tiranës si Kajo Karafili, Myslim Keta, Misto Mame, Vojo Kushi, Mihal Duri, Xhorxhi Martini, Sabaudun Gabrani, Adnat Qatipi, Njazi Meka, Shemsi Haka, Ismail Caushi, Hamit Keçi, Rexhep Kolli, Musa Karapici, Myfit Bega, Qamil Poda, Skënder Kosova, Xhelal Glina, Ali Kubati, Gani Strazimiri etj. Më 2 mars u var në litar antifashisti Hamit Shijaku, më 7 prill u kapën dhe u torturuan ilegalët Hamdi Mëzezi, Nikoll Tupja dhe Ferit Xhajko, më 12 prill ra në demonstratë Sotir Noka në Durrës, më 5 maj ra Qemal Stafa, udhëheqësi i rinisë, më 22 qershor ranë heronjtë e Shkodrës, Perlat, Jordan e Branko etj. Më 18 korrik ra në Gjirokastrë Muzafer Asqeriu, më 6 gusht 1942 ranë në Korçë Midhi Kostani dhe Kiço Greço, më 7 gusht ra Teli Ndini në Vlorë, më 16 gusht ra Misto Mame, më 20 gusht ra Mihal Duri, më 17 shtator ra në demonstratë Mine Peza, më 27 shtator ra Nazmi Rushiti, më 7 tetor ranë heronjtë e Kodrës së Kuqe në Tiranë Vojo Kushi, Sadik Stavaleci e Xhorxhi Martini, më 18 tetor ranë heronjtë e Topanasë në Vlorë Hajredin Bylishi, Hiqmet Buzi, Bajram Tushi dhe Mumin Selami, më 22 tetor ra Esat Gjyli në Shkodër dhe u var Shyqyri Ishmi në Tiranë, në nëntor

Njësitet guerile dhe heronjtë që ranë për Shqipëri



Vojo Kushi



Xhorxhi Martini



Sadik Stavaleci

ra Abdulla Keta, 7 dhjetor nga torturat vdes Emin Duraku, 24 dhjetor ra Kristo Isaku, etj. Të gjithë ishin anëtarë të njësiteve guerile, komandant të tyre, antifashistë dhe komunist të cilët i vunë gjoksin dhe gjakun e tyre lëvizjes antifashiste shqiptare.

Drejtimi dhe përgjegjësi ushtarak

Aksionet bashkërendoheshin nga një udhëheqje e vetme e përqendruar. Kështu u realizua aksioni kombëtar i 24 korrikut 1942, për prerjen e linjave telefonike në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Objektin e aksioneve e përcaktonin komitetet qarkore, ku nëpërmjet komandantëve të njësiteve guerile mblidhnin të dhëna për vendin, objektin e sulmit, njohjen e terrenit dhe rrugët e tërheqjes. Drejtuesi ushtarak merrej me përpunimin e planeve të aksioneve dhe marrjen e vendimit. Organizimi, drejtimi dhe veprimtaria e njësiteve guerile u vendos mbi baza të forta dhe unik për të gjithë. U përcaktuan rregulla të forta, të rrepta për konspiracion, për të përballuar goditjet e befasishme të armikut. Kështu numrin e njësiteve guerile e dinte vetëm qendra. Anëtarët e njësitit gueril njihnin njëri-tjetrin, por jo anëtarët e njësiteve të tjera. Ky organizim bënte të mundur të ruhej fshehtësia nga veprimtaria agjenturore e zbuluese e armikut.

Armatimi i njësiteve guerile ishte një problem mjaft i rëndësishëm, pasi kishte veçori. Anëtarët e njësiteve kishin revolverë, granata dore, lëndë djegëse e shpërthyes dhe rrallë automatik. Vëmendje e veçantë iu kushtua përgatitjes luftarake të anëtarëve, sqarimit politik dhe konspiracionit të vazhdueshëm. Stërvitja ushtarake përbënte detyrën kryesore të punës së njësiteve. Njohja dhe përdorimin e armëve e i lëndëve plasëse, nga anëtarët e njësitit bëhej në bazat ilegale. Njohja me harta topografike e skica të ndryshme të marra prej armikut, patën vlera dhe për njohjen e vendit, lehtësonte mësimin dhe përgatitjen për aksionet e vijueshme. Rritja e numrit, shtrirja dhe dendësimi i veprimtarisë së njësiteve guerile në të gjithë vendin, shtruan nevojën e përsosjes së drejtimit ushtarak. Nga fundi i vitit 1942 dhe fillimi i vitit 1943 u bënë organizime të veçanta ushtarake në komitetet qarkore, ku u dukën disa veçori në emërtim. Në Korçë u krijua shtabi ushtarak i njësiteve guerile dhe në Vlorë u ngrit komiteti ushtarak, i cili drejtohej nga sekretari politik i qarkorit, etj., ndërsa në Tiranë organizimi bëri që të quhej komanda e njësiteve guerile, ku bënë pjesë përgjegjësit e tyre, ndërsa komandantët e njësiteve kryenin drejtimin e aksioneve. Komandant të njësiteve u caktuan njerëz me e pa parti, punëtorë, fshatarë dhe të rinj, që zotëronin aftësi e njohuri të mira organizuese ushtarake.

Gjetja dhe krijimi i bazave ilegale

Zhvillimi i kryengritjes së armatosur dhe i luftës nga fundi i vitit 1942 shpunë në një lloj specializimi të njësiteve guerile. Kështu, u krijuan njësite sulmuese, sabotimi, transporti,

informimi etj., por me gjithë këtë ato vijuan të kryenin dhe detyra të tjera. Njësitet në përgjithësi kryenin detyra luftarake të ndryshme, digjnin, shkatërronin depo dhe objekte të armikut, rrëmbenin armë dhe materiale propagandistike për luftën, lironin të burgosurit politikë, organizonin dhe mbështesnin dezertimet nga radhët e armikut, mbronin bazat ku bëheshin mbledhje të rëndësishme etj. Njësitet asgjësonin hierarkë, oficerë dhe nënoficerë të policisë të karabinierisë dhe milicë fashiste, vrisnin tradhtarë dhe spiunë vendas, të cilët ishin provuar më parë si të tillë në veprimtarinë e tyre reale.

Lufta guerile shtronte si detyrë gjetjen dhe krijimin e bazave ilegale, të cilat do të shërbenin për kryerjen e veprimtarisë drejtuese dhe organizuese, për shtypin ilegal dhe aktivitetin propagandistik, për depozitim të armatimit e të materialeve të ndryshme për mjekimin e shokëve të plagosur gjatë aksioneve, si vendqëndrim dhe fshehje për guerilasit në kohë të ndryshme dhe si bazë nisjeje për aksionet e tjera. Në përputhje me këtë detyrë bazat ilegale u ngritën në rrethinat e qyteteve dhe brenda një kohë relativisht të shkurtër ato u dendësuan mjaft. Si baza shërbyen dhe u përdorën mjaft shtëpi të thjeshta të popullit, ku çdo njësit në sektorin e veprimit kishte dhe baza të tjera, rezervë.

LANÇ-i kishte hedhur tashmë urat e nevojshme dhe kishte krijuar një taban të fuqishëm për krijimin e formacioneve më të mëdha. Ky formacion luftarak ishte shfaqur shumë kohë më parë, në çetën e parë të Myslym Pezës, dhe ishte pasuar nga çeta të tjera, në disa krahina të vendit. Në këtë mënyrë nga fundi i vitit 1942 dhe fillimi i vitit 1943, ndonëse krijimi i njësiteve guerile nuk u ngadalësua, në një farë mënyre shpuri në krijimin e formacioneve më të mëdha partizane me lëvizshmëri më të lartë dhe detyra më të shumta. Kështu njësitet u shndërruan në burime për furnizimin e formacioneve luftarake më të mëdha që po shfaqeshin në territorin shqiptar.

Veprimtaria e njësiteve guerile bëri që përmasat e luftës partizane të zgjeroheshin në të gjithë Shqipërinë. Njësitet guerile ishin elementët e parë të organizimit ushtarak që pasoi me çeta partizane deri në Shtabin e Përgjithshëm, krijimin e njësiteve të mëdha operative dhe strategjike siç ishin brigadat sulmuese, divizionet dhe korparmatat. Këtë luftë epope dhe këtë gjak të derdhur për çlirimin e Shqipërisë ne duhet ta mbrojmë fort, dhe të mos lejojmë që bijtë dhe nipat e atyre që u bashkuan me pushtuesin, lyen duart me gjak ta denigrojnë, ta përbuzin e deri sa ta ndalojnë me ligj. Në Tiranë më parë kishim shumë pllaka përkujtimore që tregonin aksionet e zhvilluara nga njësitet guerile, sot ato po pakësohen dhe kjo na çon para detyrimesh të tjera për të cilat ditë dhe natë të jemi në këmbë dhe për të folur fort e për t'i bërë të njohura...

Mark Rutte merr detyrën si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s

Mark Rutte mori detyrën si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Ai u prit në selinë e NATO-s në Bruksel nga Sekretari i Përgjithshëm në largim Jens Stoltenberg, mandati i të cilit përfundon pas dhjetë vjetësh. Z. Rutte dhe z. Stoltenberg vendosën një kurorë lulësh gjatë një ceremonie në Memorialin e NATO-s për të rënë.

Në një seancë speciale të Këshillit të Atlantikut të Veriut, Stoltenberg ia dorëzoi zyrtarisht detyrën Sekretarit të Përgjithshëm Mark Rutte. “Është një nder i madh të jem këtu dhe të marr postin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s”, - tha zoti Rutte, përpara se të falënderonte aleatët që i besuan atij përgjegjësinë për të udhëhequr Aleancën në vitet e ardhshme.

Sekretari i Përgjithshëm Rutte përshkroi tre prioritetet e tij për Aleancën. “E para është të mbajmë NATO-n të fortë dhe të sigurojmë që mbrojtja jonë të mbetet efektive dhe e besueshme, kundër të gjitha kërcënimeve”, - filloi ai. “Prioriteti im i dytë është të shtoj mbështetjen tonë për Ukrainën dhe ta afrojmë atë gjithnjë e më shumë me NATO-n, sepse nuk mund të ketë siguri të qëndrueshme në Evropë pa një Ukrainë të fortë dhe të pavarur”, - vazhdoi ai, duke shtuar se “përparësia e tij e tretë është të forcojë partneritetet tona, në një botë më të ndërlidhur”.

Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu nderoi paraardhësin e tij, duke e përshkruar mandatin e tij si “shembullor” dhe duke shtuar se “sot NATO është më e madhe, NATO është më e fortë dhe më e bashkuar se kurrë, kjo është në masë të madhe për shkak të lidershit tuaj”.

Në fjalën e tij të lamtumirës, Stoltenberg përgëzoi pragmatizmin dhe aftësitë e zotit Rutte për të krijuar konsensus, ndërsa vuri në dukje se “ju nuk bëni kompromis me vlerat dhe parimet tona”. Ai vlerësoi gjithashtu angazhimin personal të pasuesit të tij ndaj “lidhjes sonë transatlantike dhe mbështetjen tuaj të palëkundur për Ukrainën”.

Komiteti Ushtarak i NATO-s përshëndet Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s në largim, Jens Stoltenberg



Gjatë kësaj periudhe, Jens Stoltenberg ruajti moralin e lartë të NATO-s, duke kontribuar aktivisht në forcimin e dialogut politiko-ushtarak aleat. “Gjatë gjithë mandatit tuaj në detyrë, ju keni treguar gjithmonë respektin më të madh dhe një kuptim të thellë të profesionit të ushtarakut. Jeni siguruar që anët politike dhe ushtarake të shtëpisë të afroheshin më shumë. Kjo është arsyeja pse lidhja midis Komitetit Ushtarak dhe Këshillit të Atlantikut të Veriut është kaq thelbësore”, - tha gjenerallejtënant Rohling.

Rohling: “Aleanca ju ka një borxh të madh. Si njeri i numrave dhe ish-ministër i financave, e di që ju e urreni borxhin. Sidomos borxhi që nuk mund të shlyhet kurrë plotësisht. Pra, ne ju premtojmë këtu, se do të përpiqemi të kthejmë borxhin tonë, duke punuar së bashku në frymën e forcës dhe unitetit, duke ndjekur shembullin që keni dhënë ju.”

Në përgjigjen e tij, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha: “Jam unë që ju kam borxh mirënjohje. Për të gjithë punën dhe bashkëpunimin tuaj gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit. NATO tani është më e madhe, më e fortë dhe më e gatshme se kurrë për të përballuar çdo sfidë. Ka qenë një privilegj i vërtetë të shërbeja si Sekretar i Përgjithshëm dhe të punoja ngushtë me Komitetin Ushtarak, Shefat e Mbrojtjes së Aleatëve dhe Përfaqësuesit Ushtarak”, - tha Jens Stoltenberg. “Sado që të jetë e trishtueshme të largohesh, qëndrueshmëria dhe forca e NATO-s nuk varen nga individët,

por nga kolektivi”.

Çfarë është një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s?

Më 1 tetor, ne i dhamë lamtumirën Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg, i cili shërbeu 10 vjet në krye të NATO-s dhe mirëpritëm Mark Rutte në këtë pozicion. Por çfarë është saktësisht një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dhe si e fiton dikush punën? Sa kohë shërbejnë dhe çfarë bëjnë çdo ditë?

Çfarë bën një Sekretar i Përgjithshëm?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s është fytyra publike e Aleancës dhe personi që drejton procesin e konsultimit dhe vendimmarrjes midis 32 Aleatëve. Nuk është një punë e lehtë, sepse 32 vende të ndryshme me 32 këndvështrime të ndryshme (dhe shumë kultura dhe gjuhë të ndryshme) duhet të bien dakord për të gjitha vendimet përpara se të zbatohen.

Si zgjidhet Sekretari i Përgjithshëm?

Aleatët e NATO-s parashtruan figura të larta politike nga vendet e tyre për postin e Sekretarit të Përgjithshëm. Vendet anëtare angazhohen në konsultime diplomatike joformale derisa të jenë në gjendje të arrijnë konsensus për një kandidat.

Sa kohë shërben Sekretari i Përgjithshëm?

Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Aleatët e NATO-s për një periudhë fillestare prej katër vjetësh, por kjo mund të zgjatet nëse të gjithë aleatët bien dakord. Për shembull, Jens Stoltenberg u zgjat katër herë për të udhëhequr Aleancën për një total prej 10 vjetësh!

Si duket përditshmëria e Sekretarit të Përgjithshëm?

Sekretari i Përgjithshëm kryeson komitetet kryesore, duke përfshirë mbledhjet e rregullta të organit kryesor vendimmarrës politik të Aleancës, Këshillit të Atlantikut të Veriut, si dhe organeve të tjera kyçe. Ata mbajnë takime me liderë nga vendet anëtare dhe partnere për të diskutuar temat në axhendën e NATO-s në selinë e NATO-s dhe jashtë saj, duke udhëtuar rregullisht nëpër botë. Ata veprojnë si zëdhënës për NATO-n, duke përfaqësuar Aleancën për publikun, për organizatat e tjera ndërkombëtare dhe për shtypin dhe median ndërkombëtare. Sekretari i Përgjithshëm është gjithashtu CEO de facto i Stafit Ndërkombëtar të NATO-s, i cili sigurohet që Aleanca të funksionojë pa probleme.



Komiteti Ushtarak i NATO-s përshëndeti zyrtarisht z. Jens Stoltenberg, mandati i të cilit si Sekretar i Përgjithshëm përfundoi, duke u pasuar nga z. Mark Rutte, ish-kryeministër i Holandës nga data 1 tetor 2024.

Nënkryetari i Komitetit Ushtarak, gjenerallejtënant Andrew M. Rohling vlerësoi udhëheqjen demokratike të Stoltenberg dhe frymën e forcës dhe unitetit që ai ka rrënjësuar në Kombet Aleate. “Z. Sekretar i Përgjithshëm, ju keni qenë një lider i vërtetë i Aleancës. Ju keni hartuar kursin tonë politik, duke ruajtur me vendosmëri busullën morale të NATO-s, të mbështetur nga vetë busulla juaj morale e pa dështueshme. I bashkove kombet dhe i frymëzove që të jenë më të mëdhenj se vetja”.

Sekretari i Përgjithshëm i dytë më i gjatë në historinë e NATO-s, Jens Stoltenberg dëshmoi disa nga vitet më të trazura në historinë e Aleancës. Ish-kryeministri norvegjez mori detyrën menjëherë pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia në 2014. Vitet në vijim panë ndryshime të mëdha në mjedisin e sigurisë, veçanërisht me pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës në 2022, sulmet terroriste, pandeminë COVID-19 dhe pranimi zyrtar i katër aleatëve të rinj të NATO-s: Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Finlanda dhe Suedia.



Vetëdija njerëzore vjen nga një dimension tjetër

Një teori e re befasuese për të shpjeguar ndërgjegjen njerëzore ka sugjeruar se ajo vjen nga dimensionet e fshehura dhe nuk është vetëm aktivitet i trurit.

Një fizikan pretendoi se ne lidhemi me këto rrafsh të padukshme të universit kur bëjmë art, praktikojmë shkencë, meditojmë filozofinë ose ëndërrojmë, dhe kjo mund të shpjegojë fenomenin që i ka shmangur të kuptuarit shkencor për shekuj.

Michael Pravica, një profesor i fizikës në Universitetin e Nevadës, Las Vegas, e ka bazuar idenë e guximshme mbi hiperdimensionalitetin, idenë se universi përbëhet nga më shumë dimensione sesa vetëm katër dimensionet që ne perceptojmë: lartësia, gjatësia, gjerësia dhe koha.

Por teoria e tij është shumë e diskutueshme, me një shkencëtar që thotë se gurthemeli i teorisë së Pravicës ‘kufizohet me fantashkencën’. “Fakti i plotë që ne mund të konceptojmë përmasa më të larta se katër brenda mendjes sonë, brenda matematikës sonë, është një dhuratë... është diçka që e kapërcen biologjinë”, - tha Pravica për “Popular Mechanics”.

Shkencëtarët janë përpjekur të shpjegojnë ndërgjegjen njerëzore dhe origjinën e saj për qindra vjet dhe një teori kryesore sugjeron se vetëdija lidhet me atë se sa informacion është i integruar midis pjesëve të ndryshme të trurit. Sa më shumë informacion të jetë i lidhur dhe i integruar, aq më e ndërgjegjshme mendohet të jetë një qenie. Një tjetër pohon se gjendjet mendore të vetëdijshme drejtohen nga sinjalizimi nga lart-poshtë në tru. Sinjalizimi nga lart-poshtë i referohet procesit me anë të të cilit rajonet e trurit të nivelit më të lartë dërgojnë informacion, prishmëri ose kontekst në rajonet e trurit të nivelit më të ulët.

Por teoria e Pravicës del jashtë sferës së neuroshkencës dhe në fizikën teorike.

Ai sugjeroi që në momentet e rritjes së vetëdijes, si kur hyjmë në një gjendje ëndrre ose përdorim trurin tonë për detyra thellësisht krijuese ose intelektuale, vetëdija jonë mund të kapërcejë dimensionin tonë fizik dhe të hyjë në një plan më të lartë. Në këto momente, vetëdija jonë sinkronizohet me dimensione të fshehura dhe merr një vërshim frymëzimi, tha Pravica.

Për të kuptuar më mirë teorisë e diskutueshme, merrni parasysh skenarin e mëposhtëm: Imagjinoni se jeni një qenie dydimensionale që jeton në një botë dydimensionale, si një personazh në një libër komik. Tani, imagjinoni që një sferë kalon përmes planit tuaj të shikimit. Sfera do të dukej si një pikë që rritet në një rreth gjithnjë e më të madh ndërsa afrohet, pastaj zvogëlohet gradualisht derisa të jetë jashtë pamjes. Nuk do të kishit se si ta dinit se është në të vërtetë një formë tredimensionale.

Pravica na sheh si një version të këtyre personazheve 2D. Edhe pse ne ekzistojmë në një botë katër-dimensionale, ne mund të perceptojmë vetëm materien dhe energjinë e atyre katër dimensioneve, ashtu si qeniet në një botë 2D nuk mund të perceptojnë një objekt 3D.

Kështu, kufizimet e botës sonë na pengojnë të zbulojmë dimensione më të larta që teorikisht mund të ekzistojnë rreth nesh.

Ky është themeli i hiperdimensionalitetit - ideja se universi



përbëhet nga shumë dimensione, disa prej të cilave janë të fshehura sepse janë përtej sferës sonë fizike.

Hiperdimensionaliteti lidhet me teorisë e fijeve, e cila thotë se realiteti përbëhet nga vargje pafundësisht të vogla vibruese që janë më të vogla se atomet, elektronet ose kuarkët.

Ndërsa fijet vibrojnë, përdredhin dhe palosen, ato prodhojnë efekte në dimensione të shumta të padukshme që krijojnë të gjitha grimcat dhe forcat që ne mund të vëzhgojmë, nga fizika e grimcave te graviteti.

“Teoria e fijeve është në thelb një teori e hiperdimensionalitetit”, - tha Pravica. “Po shikon se si universi është bashkuar në një shkallë nën-kuantike”.

Edhe pse ne mund të vëzhgojmë efektet që këto vargje vibruese kanë në fizikën e dimensionit tonë, ne nuk mund të vëzhgojmë dimensionet e fshehura në të cilat ato vibrojnë.

Kjo është, ne nuk mund t’i vëzhgojmë fizikisht. Por vetëdija jonë mund të jetë në gjendje t’i përdorë ato, thotë Pravica. Hiperdimensionaliteti dhe teoria e fijeve pranohen gjerësisht nga fizikanët, por ideja e Pravicës për marrëdhënien e tyre me vetëdijen është më e diskutueshme - veçanërisht sepse mjegullon linjat midis

shkencës dhe spiritualitetit.

Si një i krishterë ortodoks me Ph.D. nga Harvard, Pravica ka gjetur se hiperdimensionaliteti është një mënyrë për të lidhur sfondin e tij shkencor me besimet e tij fetare.

Për shembull, ai beson se Jezusi mund të jetë një qenie hiperdimensionale.

“Sipas Biblës, Jezusi u ngjit në qiell 40 ditë pasi ishte në Tokë. Si mund të ngjitesh në qiell nëse je një krijesë katërdimensionale?”, - pyeti Pravica.

Por të qenit hiperdimensional, teorikisht, mund ta ketë lejuar Jezusin të lëvizë midis botës sonë dhe parajsës - që mund të jetë një botë me dimensione më të larta ose të pafundme, tha ai.

Teoria e Pravicës bazohet në një perspektivë “Zoti i boshllëqeve”, ku boshllëqet në njohuritë shkencore shpjegohen me ndërhyrjen hyjnore, tha Stephen Holler, profesor i asociuar i fizikës në Universitetin “Fordham”.

Ai beson se ky lloj të menduari është i pamjaftueshëm dhe pengon kërkimin shkencor të nevojshëm për të kuptuar dhe shpjeguar me të vërtetë fenomene të pashprehura si vetëdija njerëzore.

“Është një mekanizëm i dobët shpjegimi që mbyl ndoshta natyrën kureshtare që kërkohet për shkencën e mirë dhe mëson se nuk është në rregull të thuash, ‘Nuk e di’”, - tha Holler për “Popular Mechanics”.

Ai thekson se aftësia jonë për të manipuluar matematikisht dimensionet më të larta nuk është provë se ato ekzistojnë në të vërtetë, ose se vetëdija jonë mund të ndërveprojë me to.

Për më tepër, eksplorimi i këtyre dimensioneve më të larta është i pamundur për shkak të kufizimeve të aftësive tona aktuale teknologjike. As përshpejtuesi më i fuqishëm i grimcave në botë - Përplasësi i Madh i Hadronit (LHC) në CERN - nuk mund të sigurojë prova reale se këto dimensione ekzistojnë.

LHC thyen grimcat së bashku me shpejtësi tepër të larta - deri në shpejtësinë e dritës. Kjo i lejon fizikanët të studiojnë blloqet themelore të ndërtimit të materies dhe energjisë dhe të kenë qasje në dimensione pafundësisht të vogla - madje edhe më të vogla se një proton i vetëm.

Por edhe LHC nuk është në gjendje të zbulojë vargjet me dimensione të larta që parashikon fizika kuantike. Për të marrë atë të grimcuar, fizikanëve do t’u duhej një përplasës shumë më i fuqishëm.

Pa këto prova konkrete, Holler thotë se hiperdimensionaliteti ‘kufizohet me fantashkencën’. Por Pravica është optimist se një teknologji e tillë mund të ekzistojë brenda jetës së fëmijëve të tij.

Deri atëherë, ai do të vazhdojë të mbështesë hiperdimensionalitetin dhe teorisë e tij se si ai lidhet me ndërgjegjen tonë. “Unë nuk shoh asnjë kuptim ndryshe”, - tha ai. “Pse të studiojmë? Pse të jetosh?”.



Industria e mbrojtjes duhet të investojë në teknologji dhe zgjidhje të avancuara të sigurisë kibernetike për të mbrojtur rrjetet, sistemet dhe të dhënat e ndjeshme të tyre. Këto zgjidhje përfshijnë zbatimin e sistemeve të fuqishme mbrojtëse, sistemet e zbulimit dhe parandalimit të ndërhyrjeve, mekanizmat e enkriptimit, përdorimin e AI-së për të përmirësuar analitikën dhe zbulimin e kërcënimeve, dhe trajnimin e personelit ushtarak për të ndërtuar elasticitet ndaj sulmeve kibernetike të ardhshme.

Për më tepër, kompanitë e mbrojtjes duhet të shikojnë bashkëpunimin me partnerët e industrisë dhe agjencitë qeveritare, pasi bashkëpunimi mund të përmirësojë pozicionin e sigurisë kibernetike, duke ndarë informacionin dhe praktikatat më të mira për të ndihmuar të gjitha palët të identifikojnë kërcënimet në zhvillim. Investimi në sigurinë kibernetike është thelbësor për kompanitë e mbrojtjes dhe ushtritë për të mbrojtur infrastrukturën kritike kombëtare, duke parandaluar aktorët armiqësorë që të marrin kontrollin e informacionit të ndjeshëm dhe të ruajnë sigurinë kombëtare.

Rrjedhimisht, investimi në aftësitë e sigurisë kibernetike është thelbësor për të fituar një avantazh ndaj kundërshtarëve të tyre dhe për të parandaluar aktorët armiqësorë nga aksesit i të dhënave të mbrojtjes dhe informacionit të armëve.

Si e përshejton dixhitalizimi nevojën për siguri kibernetike?

Sistemet e dixhitalizuara të mbrojtjes janë objektiva për aktorët armiqësorë që kërkojnë të kenë akses në të dhëna të ndjeshme dhe të ndërpresin komunikimin. Për shembull, mbrojtësi i huaj kibernetik i Ukrainës, Team OneFist, vodhi të dhëna të ndjeshme nga firmat ushtarake ruse me vlerë 1.5 miliardë dollarë dhe hakoi pajisje të tilla si kamera për të spiunuar trupat ruse.

Praktikat e sigurisë kibernetike mund të ndihmojnë në mbrojtjen e kompjuterëve, serverëve, pajisjeve mobile, rrjeteve dhe të dhënave nga sulmet me qëllim të keq. Për shembull, kompanitë e mbrojtjes dhe ushtritë që përdorin zgjidhje të sistemeve mbrojtëse (firewall) do të mbrojnë kompjuterët ose rrjetet e tyre nga trafiku i padëshiruar. Një sistem mbrojtës mund të monitorojë dhe kontrollojë trafikun e padëshiruar midis një rrjeti të brendshëm (i besuar, i sigurt) dhe një rrjeti të jashtëm (jo i besueshëm). Më pas mund të bllokoi aksesin e paautorizuar në rrjet dhe të përcaktojë identitetin e sulmuesve të mundshëm.

Si ndikojnë të dhënat e mëdha (big data) në sigurinë kibernetike?

Industritë farmaceutike dhe të kujdesit shëndetësor janë objektivat kryesore të aktorëve të rrezikshëm kibernetikë për shkak të sasisë së madhe të të dhënave të vlefshme dhe të ndjeshme dhe IP-së që ata mbajnë. Prandaj, është jetike për kompanitë e shkencave të jetës që t'i mbrojnë këto asete. Ndërsa industria bëhet më e dixhitalizuar, kriminelët kibernetikë kanë më shumë rrugë për të vjedhur të dhëna personale dhe pronësore, duke përfshirë të dhënat shëndetësore mjekësore dhe pajisjet mjekësore të lidhura. Pajisjet e lidhura që mbledhin të dhëna personale të shëndetit, të tilla si pajisjet e veshura, shkëmbejnë shpesh të dhëna me pajisjet e çiftuara përmes Bluetooth, gjë që i bën ato veçanërisht të ndjeshme ndaj hakerimit. Për më tepër, pajisjet individuale që përmbajnë informacione personale për shëndetin në përgjithësi kanë pak mbrojtje kibernetike dhe shpesh nuk janë të lidhura me rrjetet e menaxhuara. Pajisjet individuale do të përfitonin nga zbatimi i softuerit të sigurisë kibernetike si siguria e rrjetit, menaxhimi i cënueshmërisë dhe menaxhimi i identitetit.

Si e përshejton mbingarkesa e të dhënave nevojën për siguri kibernetike?

Rrjedhat në rritje të të dhënave që përfshijnë ciklin OODA do të thotë se më shumë pajisje të lidhura duhet të jenë të sigurta në internet. Drejtori i testimit dhe vlerësimit operacional në Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-së konfirmoi se “pothuajse çdo armë në arsenalin e luftëtarit është e përcaktuar nga softueri dhe ne kemi më shumë gjasa të përmirësojmë fikjen e sistemit, duke instaluar softuer të ri sesa duke modifikuar harduerin”.

Megjithatë, çdo përditësim i softuerit mund të vijë me rrezikun e vet të sigurisë kibernetike. Të dhënat në çdo format kanë qenë gjithmonë një diskriminues kryesor në fushën e betejës, duke ofruar informacion të vlefshëm që mund të përpunohet dhe të shndërrohet në një produkt të zbatueshëm për përdoruesit e vijës së parë. Megjithatë, meqenëse cikli OODA mbështetet gjithnjë e më shumë në strategjinë dhe planifikimin kompleks, çdo shkelje e të dhënave do të ishte një grusht shteti i rëndësishëm i inteligjencës nga një forcë armike.

Mbledhja e përhapur e të dhënave gjithashtu nënkupton që kompanitë dhe institucionet ushtarake gjithnjë e më shumë e japin menaxhimin e tyre të të dhënave. Kjo do të përshejtojë nevojën për sigurinë kibernetike pasi aktorët e këqij preferojnë të synojnë furnizuesit më të vegjël ndaj kontraktorëve më të mëdhenj të mbrojtjes në vend që të përpiqen të sulmojnë kompanitë më të mëdha që mund të përballojnë të shpenzojnë më shumë për sigurinë kibernetike.

Një fushë tjetër ku siguria kibernetike do të luajë një rol të rëndësishëm është sektori i sistemeve pa pilot. Rritja e përdorimit të sistemeve pa pilot do të kërkojë investime shtesë në sigurinë kibernetike për shkak të dobësive të tyre. Automjetet pa pilot janë pjesë e ekosistemit më të gjerë të IoT dhe natyra e ndërlidhur e sistemeve IoT rrit rrezikun e hakerave dhe sulmeve kibernetike. Kontrolli i tyre është një proces që përfshin marrjen dhe dërgimin e të dhënave drejt dhe nga një stacion kontrolli, shpesh duke përdorur telekomunikimet satelitore.

Në disa raste, këto sisteme duhet të funksionojnë në zona pa sinjal (p.sh., male, nën ujë) dhe të mbështeten në kompjuterët e tyre në bord për të vazhduar misionin. Prandaj, sigurimi i tyre kundër sulmeve kibernetike është kritike, jo vetëm për informacionin që ata posedojnë, por edhe për faktin se një numër në rritje platformash

Ndikimi i sigurisë kibernetike në sektorin e mbrojtjes



janë të armatosura me sisteme armësh vdekjeprurëse, të cilat mund të përdoren kundër forcave aleate nëse një ent armiqësor fiton kontrollin mbi pajisjet pa pilot, funksionet e komandës dhe kontrollit të platformës.

Si e përshejton kompleksiteti i IoT nevojën për siguri kibernetike?

Ushitari modern është bërë më i lidhur dhe ushtritë, tani janë më të varur nga IoT. Kjo e bën një domosdoshmëri të madhe sigurimin e pajisjeve IoT kundër kërcënimeve të sigurisë kibernetike. Sipas Ron Stefanski, profesor biznesi në Kolegjin e Kembrixhit, “zgjerimi i pajisjeve të ndërlidhura që vijnë me IoT gjithashtu zgjeron sipërfaqen e kërcënimit për sulme të mundshme kibernetike... prandaj është e domosdoshme që kompanitë ADS të zbatojnë masa mbrojtëse të forta sigurie për të forcuar ekosistemin e tyre teknologjik në zhvillim”.

Kryerja e një hetimi të plotë të rreziqeve të sigurisë kibernetike dhe investimi në softuer anti-malware do të identifikojë dobësitë e mundshme në sistemet dhe rrjetet kompjuterike. Kompanitë e mbrojtjes mund të zhvillojnë më pas strategji për të zburat ato rreziqe. Për shembull, agjencitë izraelite thuhet se përdorin softuerin “Pegasus” për të spiunuar komunikimet celulare të Hamasit. “Pegasus” është një malware me “klikim zero” që vendoset në pajisjen e komunikimit të një objekti dhe aktivizohet pa e ditur ose pa pasur nevojë të klikojnë ndonjë lidhje, duke i dhënë sulmuesit akses në të gjithë pajisjen celulare dhe të dhënat e objektit.

Rrjetet 5G përmirësojnë komandën dhe kontrollin në kohë reale (C2) në fushën e betejës, duke ofruar lidhje me teknologji të tilla si AI, sistemet pa pilot dhe rrjetet cloud. Për shembull, aplikacionet AI të aktivizuara me 5G mund të përpunojnë informacionin shumë më shpejt dhe të analizojnë të dhënat në mënyrë më efikase.

Zbatimi i sistemeve të monitorimit dhe mekanizmave të zbulimit të kërcënimeve mund të ndihmojë kompanitë dhe ushtritë të identifikojnë dhe të zbusin sulmet e mundshme kibernetike. Përfshirja e mjeteve të specializuara të AI-së që mund të automatizojnë zbulimin e kërcënimit dhe cënueshmërisë, duke përdorur modelimin parashikues të të dhënave për të analizuar sjelljen e rrjetit do të rrisë më tej aftësitë kibernetike mbrojtëse.

Si e përshejton adoptimi i AI-së nevojën për siguri kibernetike?

Inteligjenca artificiale është një mjet si për mbrojtjen nga sulmet kibernetike ashtu edhe për nisjen e tyre. AI-ja mund të përshejtojë malware, duke lejuar që kodi të ndryshojë vazhdimisht, duke e bërë kështu më të vështirë zbulimin. Teknika më të sofistikuar të AI-së mund t'u mundësojnë hakerëve të anashkalojnë sigurinë e fytyrës dhe filtrat e postës së padëshiruar, të prodhojnë komanda të rreme zanore dhe të shmangin motorët e zbulimit të anomalive. Teknologjitë e reja autonome mund të përdoren gjithashtu për operacione sulmuese kibernetike, të cilat përfshijnë identifikimin dhe shfrytëzimin e dobësive në infrastrukturën e një entiteti armiqësor. Kjo strategji synon të fitojë një avantazh ndaj armikut, duke përdorur dobësinë e tyre në hapësirën kibernetike. Operacionet fyese kibernetike përfshijnë aktivitetet si hakerimi dhe shkeljet e të dhënave. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto operacione mund të kontribuojnë gjithashtu në rritjen e sigurisë kibernetike të aleatëve, duke siguruar kështu sigurinë dhe gatishmërinë e tyre.

DoD e SHBA-së ka zhvilluar një strategji për operacionet kibernetike sulmuese që fokusohet në mbrojtjen e domenit kibernetik në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët. Objektivi është të mbështesë zhvillimin e aftësive të tyre kibernetike, duke rritur potencialin për bashkëpunim në të ardhmen kibernetike.

Duke punuar së bashku, aleatët mund të përmirësojnë qëndrimin e tyre kolektiv të sigurisë kibernetike dhe të mbrohen në mënyrë efektive kundër kërcënimeve kibernetike.

Një qasje mbrojtëse e aktivizuar me AI-në lejon forcat kibernetike të qëndrojnë përpara kërcënimit pasi teknologjia e mësimit të makinerive (ML) përmirëson shpejtësinë dhe efikasitetin e zbulimit të kërcënimit dhe kundërmasave. Zgjidhjet ML mund të rrisin saktësinë e zbulimit të kërcënimit dhe të autorizojnë përgjigje të menjëhershme autonome për të reaguar ndaj sulmeve të reja kibernetike të gjeneruara nga AI-ja. Inovacione të tilla si ML, malware i aktivizuar me AI dhe teknologjia cloud pritet të mundësojnë një qasje më proaktive ndaj sigurisë kibernetike. Për më tepër, duke trajnuar profesionistët e sigurisë kibernetike në teknikat dhe teknologjitë më të fundit, ata mund të kuptojnë dhe identifikojnë

sulmet e udhëhequra nga AI-ja.

Trajnimi përfshin të mësuarit për të njohur modele dhe sjellje që tregojnë qëllime keqdashëse dhe përdorimin e mjeteve dhe algoritmeve të AI-së për të analizuar të dhënat për nënshkrimet e kërcënimit të mundshëm. Si rezultat, kompanitë dhe ushtritë e mbrojtjes mund të identifikojnë dhe zbusin më mirë sulmet kibernetike përpara se ato të shkaktojnë dëme në reputacionin ose sigurinë e industrisë. Rrjedhimisht, profesionistët e sigurisë kibernetike janë thelbësorë për të mbrojtur sistemet dhe të dhënat e mbrojtjes dhe për të rritur gatishmërinë dhe aftësitë ushtarake përballë kërcënimeve kibernetike të bazuara në AI.

Si e përshejton lufta hibride nevojën për siguri kibernetike?

Tensionet gjeopolitike midis vendeve mund të rezultojnë në sulme kibernetike si një mjet hakmarrjeje ose për të fituar një avantazh strategjik. Vendet me marrëdhënie të tensionuara politike shpesh synojnë aftësitë ushtarake, financiare dhe infrastrukturore të njëri-tjetrit me sulme kibernetike.

Këto sulme po bëhen më agresive dhe janë një kërcënim për sigurinë kombëtare për shkak të aftësisë së tyre për të prishur dhe dëmtuar reputacionin e kompanive të mbrojtjes dhe për të marrë informacion të klasifikuar. Për shembull, “Lockheed Martin” ishte në shënjestër të një sulmi ransomware në 2022 nga “Killnet”, një grup pro-rus që është i specializuar në mohimin e shërbimit (DoS) dhe sulmet e shpërndara të mohimit të shërbimit (DDoS) dhe pretendoi se kishte nxjerrë të dhëna identifikimi të personelit të punonjësve të “Lockheed Martin”.

Që nga pushtimi rus i Ukrainës në shkurt 2022, frekuenca e sulmeve kibernetike kundër objektivave ukrainase është rritur, me pasoja të ndjera në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Instituti “CyberPeace” raporton se në maj 2023, ka pasur 1,998 sulme kibernetike kundër Ukrainës, me operacione të kryera nga 98 aktorë të ndryshëm. Këto incidente synuan 23 sektorë kritikë, duke përfshirë financat dhe kujdesin shëndetësor, dhe u shtrinë në 49 vende të tjera, si Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Zvicra dhe SHBA.

Zbatimi i zgjidhjeve dhe praktikave të sigurisë kibernetike si Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) e Parlamentit Evropian, një pjesë integrale e politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së, do t'u mundësojë forcave ushtarake të rrisin aftësitë në operacionet paqeruajtëse dhe parandalimin e konflikteve, duke forcuar sigurinë ndërkombëtare. Sipas një raporti të 2023 nga Parlamenti Evropian, CSDP është një “shtyllë kyçe e Busullës Strategjike të BE-së drejt forcimit të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes”.

Zbatimi i CSDP do të mbështesë strategjinë për rritjen e elasticitetit të sektorit të sigurisë, duke përfshirë sigurinë kibernetike, luftën kundër dezinformimit dhe operacionet e tjera të koordinuara të informacionit.

Më 7 maj 2024, Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar (MM) pësoi një sulm kibernetik të dyshuar kinez që ekspozoi të dhënat personale të dhjetëra mijëra personel ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar. Sulmi kibernetik synoi sistemin e listës së pagave të Ministrisë së Mbrojtjes, duke përfshirë emrat dhe detajet bankare të pjesëtarëve aktualë dhe të mëparshëm të forcave të armatosura.

Pasojat e dështimit për të investuar në masat e sigurisë kibernetike mund të jenë të rënda dhe të gjera, duke dëmtuar financat dhe reputacionin e industrisë së mbrojtjes, duke rritur shqetësimin për humbjen e mundshme të kontrollit mbi armët dhe pajisjet ushtarake, duke ndërprerë zinxhirët e furnizimit dhe duke çuar në probleme me pasojat të rënda ligjore ose rregullatore.



Grup partizanësh të Brigadës XXIV Sulmuese.



KOLONEL (R) SALI ONUZI

Brigada XXIV në çlirimin e Tiranës dhe të Shkodrës

Brigada 24 e UNÇSH-së u krijua, më 4 tetor 1944, në Bicaj me 560 partizanë të batalionit të Lumës dhe vullnetarë të rinj nga krahinat e Kukësit. Brenda muajit tetor 1944, Brigada do të kapte shifrën e 1000 luftëtarëve. Në fund të Luftës ajo kishte 1185 partizanë. Aty, në kodrën ku u krijua ngrihet madhështor Lapidari që i kushtohet dëshmorëve dhe veprimtarisë luftarake të saj.

Nuk ishte hera e parë që lumjanët krijojnë një formacion të madh luftarak. Të tilla, ata kishin ndërtuar në kohën e Lidhjes së Prizrenit, 1878-1881, e sidomos në kryengritjet e viteve 1910-1912 kundër ushtrisë osmane dhe pastaj kundër agresionit serb. Por kjo Brigadë që po formohej ishte një formacion i ri. Jo vetëm nga mosha. Këtu kishte standarde të tjera. Në skuadër, togë, kompani e batalion kishte shokë nga fshatra e krahina të tjera, ndryshe nga çetat e dikurshme që plotësoheshin vetëm nga fshati ose batalioni vetëm nga bajraku. Në Brigadën XXIV S kishte partizanë nga Luma nga Gora e Dibra, po edhe nga Labëria, më pas edhe nga Lezha e Shkodra, Komisari i Brigadës major Abedin Shehu ishte nga Luma, por komandanti i saj, major Ndreko Rino ishte nga Gjirokastra, zëvendës komisari Ethem Gjinushi ishte nga Tepelena, si dhe disa kuadro të tjerë. Ashtu si lumjanët kishin luftuar e luftonin në krahina të tjera, si Xhemali Mani, që kish rënë dëshmor në skelën e Vlorës, duke luftuar kundër ushtarëve italianë, më 7 prill 1939, si Qazim Mata, që ish plagosur rëndë po atë ditë në Durrës, si Elez Braha, zëvendëskomandanti i batalionit të famshëm “Shqiponja” të Korçës që ra në krye të tij, më 14 dhjetor 1943, në betejën e Gurit të Kamjes, si Maksut Rexhepi ish-partizan në Br.1 që do të binte trimërisht në Betejën e Tiranës, si Meriman Braha, Hasan Luma e Xhemali Bileri, që kishin rënë dëshmorë në Dibrën e Poshtme, si Rrahman Parllaku që e kish nisur luftën në Vlorë e do ta përfundonte si komandant i divizionit V në Kosovë, si Imer Domi në Dibër të Sipërme e të tjerë. Brigada partizane ishte një formacion i disiplinuar, me hierarki të respektuar, nga bindja në radhë të parë, po dhe nga funksionet e gradat.

Këtu në Brigadë luftohej, po edhe mësohej shkrim e këndim. Kishte edhe komisar kompanish që ishin mësues. Komisari i


kompanisë së dytë të bat.3, Ahmet Onuzi, mësues, mbante edhe armën për të luftuar po edhe mandolinën për të shoqëruar rapsodët partizanë pas luftimesh. Në Brigadë do të kishte edhe një vajzë, Teuta Agolli nga Dibra, përgjegjëse e rinisë e batalionit të katërt.

Kjo brigadë e krijuar sipas parimit të madh të LANÇ-it, pa dallim feje, krahine e ideje, do të kishte edhe myslimanë, edhe bektashinj, edhe katolikë, patriotë. Kishte edhe komisarë politik në kompani batalion e Brigadë, kishte edhe komunistë, të cilët mund

të dalloheshin vetëm ngaqë prinin në ballë të sulmit në vendet më të rrezikshme dhe binin me nder në fushën e luftës.

Brigada XXIV do të nisej drejt Jugut për të marrë pjesë në çlirimin e Tiranës. Drejt jugut, nuk ishte edhe ky një teatër i ri luftarak. A nuk kish kaluar nëpër Lumë Isë Boletini, në nëntor 1912, me 100 trimat e tij për të shkuar në Vlorë, a nuk kishin shkuar lumjanët me Bajram Currin deri në Tiranë në qershor 1924, 20 vjet më parë?





Vehbi Shehu




Ethem Gjinushi



Abedin Shehu



Ndreko Rino



Hasan Kerxhaliu

Edhe atëherë për çlirimin e kryeqytetit kishin luftuar, ashtu siç kishin luftuar denbabaden për çlirimin e mbrojtjen e kryeqytetit të Shqipërisë etnike, Prizrenit.

Ndonëse ishte një Brigadë e re, për partizanët e saj ky ishte një nder. Nuk ish problem, kishin dalë në luftë për të çliruar Shqipërinë, jo thjeshtë krahinën e fshatin e tyre. Në Betejën e madhe për çlirimin e Tiranës merrnin pjesë brigada nga më të shquarat e UNÇSH-së, si Brigada I, IV, VIII, që kishin bërë emër an’ e kënd Shqipërisë. Aty do të thirreshin edhe disa Brigada të reja, si X, XVII XXIII, dhe XXIV. Posaçërisht, siç kish urdhëruar Komanda e Përgjithshme, edhe për të marrë përvojë, por edhe për të bërë histori. Lumjanët i kish prekur aty ku ishin më të ndjeshëm. Donin të bënin emër. Për ta, lufta ishte edhe një garë për t’u dalluar mbi të tjerët. Kështu kish ardhur kjo ambicie luftarake nga brezi në brez. A nuk kishin thënë historianët ushtarakë osmanë se Luma prodhon luftëtarë?! “Për hajër”, “me faqe të bardhë”, “mos na koritni”, këto ishin fjalët e lumjanëve për djemtë e tyre që po hynin në këtë Brigadë.

Kronika e luftimeve të Br. XXIV përmbante një pritë kundër forcave gjermane në rrugën Kukës-Prizren dhe një marshim të sforcuar tre ditor nga Luma në Mat e në Tiranë, ku arriti me datën 10 nëntor. Rajoni i saj i luftimeve shtrihej nga Medreseja në Laprakë dhe në kodrat e Domjes me thellësi deri në Laknas, në krahun e djathtë të rrugës, midis Brigadës së I dhe Brigadës XXIII, që luftonte nga Vora e më tej. Përballë saj në anën tjetër të rrugës ishte Brigada X dhe batalioni “Antonio Gramshi”. Detyra e tyre ishte të bllokoni hyrjen dhe daljen e forcave gjermane nga Tirana.

Në Tiranë mbrohej një garnizon i fuqishëm gjerman, i pajisur me tanke, autoblanda dhe artileri të rëndë. Brigada XXIV nga 11 deri më 17 nëntor zhvilloi në rajonin e saj 10 luftime kundër forcave gjermane, në kushte të vështira moti (shiu të dendur), në mungesë të theksuar të armëve kundërtanke. Ndërkohë nga Vora niseshin grupe të fuqishme për t’u futur në Tiranë. Kundër tyre Brigada XXIV dhe Brigada X, kishin ndërtuar barrikada në rrugë. Tanket gjermane pasi i gjuanin barrikadat me predha, së fundi sulmonin për t’i shkatërruar fizikisht me peshën e tyre të blinduar. Në këto ndeshje të egra me tanket gjermane partizanët e Br. XXIV luftonin me armët e këmbësorisë, me ndonjë granatë, e rrallë, ndonjë anti-tank. Plus faktit që ata ishin një Brigadë e sapokrijuar, e pastërvitur

për luftën në qytete dhe kundër tankeve.

Ditën që filloi sulmi vendimtar i forcave të Korparmatës I për çlirimin e Tiranës më 11 nëntor, forcat e Br. XXIV kryen tre sulme, njërin te Ura e Lanës (mbi rrugën Tiranë-Vorë), një tjetër tek ura mbi lumin e Tiranës në rrugën Tiranë-Kamëz, të tretin kundër pikëmbështetjes armike në Domje. Si rrjedhojë autokolona gjermane s’hyri dot në Tiranë dhe mori drejtimin për Shkodër.

Më 13 nëntor, forcat e Br. XXIV në bvp, e forcat e Br. X, u mbrojtën kundër një force prej rreth 1000 ushtarë të nisur nga Vora, shoqëruar me tanke, dhe një kompanie tjetër armike të nisur me të njëjtën detyrë nga Tirana të hapnin rrugën për në Vorë. Për më shumë se 5 orë, prej Laprake deri në Kashar, u zhvilluan kundër tyre luftime të përgjakshme. Megjithëse trupat gjermane, pasi lanë në rrugë shumë të vrarë, mundën të hynin në Tiranë në mbrëmje, rruga Tiranë-Vorë mbeti përsëri e bllokuar.

Më 14 nëntor, po ai batalion gjerman, i nisur nga Tirana për në Vorë, për të spastruar dy anët e kësaj rruge, u godit nga Brigada XXIV në dalje të Tiranës dhe kur mbërriti ne Mëzes, u godit nga forca të Br. X. Vetëm pasi ishte errur, gjermanët u vunë përsëri në lëvizje drejt Vorës. Më 15 nëntor, forca të Brigadës XXIV i dëbuan gjermanët nga autorepartit në dalje të Tiranës nga rruga e Durrësit dhe po këtë ditë, dy batalione të saj zhvilluan me forca gjermane një përleshje të përgjakshme në terrenin e Laknasit. Më 16 nëntor dy batalione të Br. XXIV e goditën dhe e shpartalluan rëndë grupin e luftimit armik që sulmoi nga fusha e aviacionit për të çelur me çdo kusht rrugën Tiranë-Vorë. Trupat gjermane, të përqendruara në Vorë, u shtrënguan të tërhiqeshin e mbylleshin në fortifikata. Po atë ditë, një batalion i Br. XXIV dhe një kompani e BrIs sulmuan armiq të në afërsi të autorepartit.

Natën e 16-17 nëntorit forca të Br.XXIV dhe të Br.X goditën trupat gjermane që u tërhoqën përfundimisht nga Tirana për në Vorë. Ushtarët gjermanë të bashkuar me trupa të tjera që vinin nga Vora, të shumtë në numër e të shoqëruar me tanke, çanë pritën e vazhduan tërheqjen. Më 17 nëntor partizanët e Korparmatës I çliruan Tiranën.

Brigada ka zhvilluar këtu luftimet më të ashpra në historinë e saj. Përballë tankeve dhe autoblandave gjermane, partizanët e Brigadës vunë gjokset e tyre duke shkruar faqe heroizmi të pashembullt. Tipik është luftimi dhe rënia e komandantit të kompanisë së dytë

Vehbi Shehut dhe dy partizanëve të tjerë, Nuredin Brahës dhe Sadik Palushit. Bashkëluftëtari i së njëjtës llogore me to, Sadik Kërzhaliu, ka treguar kështu: “Dy tanke përpara dhe një autobлиндë pas tyre po vinin drejt barrikadës së kompanisë së dytë... Vehbi Shehu me granata dhe një pushkë anti-tanke në dorë u nis në sulm drejt tankut të parë duke qëlluar mbi të. Kur u afrua 6-7 metra mori të hidhte granatat, por në këtë çast autoblanda e qëllon për vdekje. Ai ra buzë xhadesë afër barrikadës. Togkomandanti Nuredin Braha, dhe pas tij Sadik Palushi, u hodhën në sulm kundër tankeve, qëllonin me bomba dore dhe përparimi i tyre u bllokua. Nuredini mori në krah komandant Vehbiun për ta tërhequr, por sa u ngrit në këmbë u godit me dy predha, njëra në kokë dhe tjetra në anën e djathtë të gjoksit. Megjithatë ai ecte duke u lëkundur e i larë në gjak, në ndihmë i shkoi Sadiku, por edhe ky ra i vdekur nga plumbat e armikut. Nuredini bëri disa hapa, por nga plagët e rënda dhe pesha e komandantit që mbante në krah ra përtokë përpara pozicioneve ku po luftonte ...e gjithë kompania jonë. Barrikadën tonë lumjane nazistët nuk e kaluan dot”.

Kështu ranë si trimat 16 partizanët te Brigadës XXIV, nga 194 luftëtarë që ranë dëshmorë për çlirimin e Tiranës. Mu te Kthesa e Kamzës, në dy pllaka të thjeshta mermeri janë gdhendur emrat e tyre. Tetë prej tyre ranë aty te kthesa e Kamzës dhe po aq ranë në pozicionet e tjera majtas e djathtas, nga ish-autorepartit (sot Instituti Harry Fultz) e deri në kodrat e Domjeve. Këta janë: Abaz Tahir Peposhi, Lusën, Dervish Hasan Hasani, Dibër, Elmaz Hasan Ademi, Bardhoc, Gani Hajdin Duraku, Morin, Hakik Sherif Gjici, Bushtricë, Idriz Nuri Gafurri, Çajë, Maliq Imer Topuzi Dibër, Nuredin Tahir Braha, Bicaj, Osman Halit Qinani, Arrën, Ramadan Muharrem Kotarja, Gjegje, Ramadan Hamit Shahu, Bardhoc, Sabri Islam Gjici, Bushtricë, Sadik Tahir Palushi, Palush Shefit Mehmet Smana, Çajë, Vehbi Ramadan Shehu, Bicaj, Xheladin Nuredin Mici, Gjegjën. Emri i shtatëmbëdhjetë është i dëshmorit të Br.I, Maksut Rexhepi.

Më 17 nëntor Br. XXIV dhe XXIII morën urdhër që t’i ndiqnin trupat gjermane drejt Shkodrës. Më 22 nëntor në luftime kundër gjermano-ballistëve në Krujë bie partizani Xhafer Ollomani nga Borja. Më 24 -29 nëntor 1944, Brigada XXIV do të sulmonte për çlirimin e kryeqendrës historike të Veriut dhe terreni i saj i luftimit do të ishin kodrat e Bërdicës dhe të Beltojës, përballë mbrojtjes së fortifikuar gjermane dhe artilerisë së rëndë të vendosur në Kalanë e Rozafës. Në portat e Shkodrës ranë edhe 5 partizanë të tjerë të Brigadës së 24 S: Emri Metush Halilaj nga Bicaj, Hasan Hysen Lika nga Lusna, Islam Ramadan Xhahu nga Gjegjini, Isuf Jashar Seferi nga Fshati dhe Imer Ramadan Mata nga Zapodi.

Me pjesëmarrjen në çlirimin e Tiranës dhe të Shkodrës, me 22 dëshmorët e rënë këtu, Brigada e XXIV e kaloi me sukses provën e saj historike. Brigada u shpërnda në maj 1945.

Në këtë 80-vjetor të krijimit të saj, kujtojmë me nderim dhe mirënjohje dëshmorët e saj, gjithë ish-partizanët dhe kuadrot e tjerë drejtues si komandantin Ndreko Rino, (Hero i Popullit) komisarin Abedin Shehu e Zenel Hamiti, ish-kuadrot e Brigadës: Et’hem Gjinushi, Nijazi Hoxha, Petro Lalaj, Rasim Guri, dhe të batalioneve :Madan Haxhiu , Filat Muça , Teki Hasani , Abaz Shehu, Muhedin Kërzhaliu, Hasan Kerxhaliu (Hero i popullit) Anesti Andoni, Xhelal Gjidedaj e Llazi Lipivani, Abdi Mati, Ismail Shehu, Ramadan Halilaj, Teuta Agolli, Maliq Gashi, Hazir Onuzi, Nexhip Visha etj. Veteranët e saj sot janë të rrallë. Por ka prej tyre si Tosun Tota, që ndonëse 98 vjeç nuk mungon kurrë të bëjë homazhe e t’u flasë pasardhësve të veteranëve, rinisë e nxënësve te Lapidari që i kushtohet dëshmorëve te Brigadës këtu në Tiranë, te kthesa e Kamzës.




www.mod.gov.al

Qendra e Personel Rekrutimit

STUDIME USHTARAKE NË SHBA

AFATI KOHOR I DORËZIMIT TË
DOKUMENTAVE TË REGJISTRIMIT
PRANË QENDRËS SË PERSONEL
REKRUTIMIT :

23 TETOR 2024



OFROHEN DY BURSA TË PLOTA STUDIUMI NË :

AKADEMINË USHTARAKE WEST POINT
(1 KUOTË)

AKADEMINË USHTARAKE DETARE
(1 KUOTË)

PËR MË SHUMË INFORMACION

VIZITONI FAQEN ZYRTARE TË
WEB-IT :

WWW.MOD.GOV.AL

KU DO TË GJENI FORMULARËT
PËRKATËS MBI KRITERET E
APLIKIMIT DHE PRANIMIT